

Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmën

Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen

Leon Malazogu dhe **Florian Bieber**
me kontribut nga **Drilon Gashi**

Prishtinë, shtator 2012

Copyright © 2012. Projekti për Marrëdhënie Etnike – Kosovë (PER-K) dhe Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar etj., pa lejen me shkrim të PER-K dhe D4D.

Përgatitur nga:

Leon Malazogu dhe Florian Bieber

me kontribut nga Drilon Gashi

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Masat për ndërtim të mirëbesimit në Kosovë” me përkrahje financiare nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe përkrahje shtesë nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD), një projekt i German Marshall Fund të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e këtij raporti është krejtësisht përgjegjësi vetëm e Projektit për Marrëdhënie Etnike - Kosovë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si diçka që reflekton pozicionin e Bashkimit Evropian, BTD-së, German Marshall Fund apo Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, apo ndonjë organizate tjetër.

Përmbajtja

Përmbledhje, 4

Hyrje, 7

Kronologjia e dialogut, 9

Shqyrtim i çështjeve në diskutim, 11

Një vit i shtirjes dhe dialogut të detyruar, 25

Pozicionimi i palëve të interesit, 32

Shtytjet për bashkëpunim, 43

Drejt dialogut politik, 53

Dinamika e proceseve të reja, 61

Rekomandimet, 70

Fusnotat, 72

Përmbledhje

Me gjithë të metat e dukshme, dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qenë ndërmjetësimi më i suksesshëm në mes të këtyre palëve që mbahet në mend. Kjo përvojë e dialogut teknik është e dobishme tani që palët para përgatiten për të diskutuar çështje më të ndjeshme dhe komplekse dhe ku rreziqet janë më të larta. Krijimi i besimit, karotat dhe shkopi si dhe kushtëzimi janë të domosdoshme për të përmbyllur suksesshëm këtë proces ndërmjetësimi.

Ky punim identifikon disa faktorë të rëndësishëm që shpjegojnë performancën e dialogut deri më tani. Dy nga këta faktorë ishin veçanërisht të rëndësishëm dhe duhet të forcohen. Ndërmjetësimi i BE-së e ka bërë të mundshëm shpërblimin e të dy palëve për progresin e arritur në dialog, duke tejkalluar kështu logjikën e shumës zero, që ka qenë tipar i të gjitha përpjekjeve të mëhershme. Për më tepër, shtetet e fuqishme kanë përdor kushtëzim, duke ndihmuar për të ndryshuar perceptimin e interesave vetanake.

Megjithatë, shumë-kuptueshmëria që ka ndihmuar arritjen e disa marrëveshjeve, si ato për lirinë e tregut, diplomave universitare dhe kadastrës, u dëshmuar që është armiku kryesor i zbatimit të tyre. Interpretimet e ndryshme kanë kontribuar drejt ndjenjës së suksesit të pjesshëm, por edhe kanë dëmtuar krijimin e besimit. Gjatë dialogut, palët nuk kanë mundur t'i kontribuojnë stabilitetit më të madh të raporteve të tyre për shkak se kanë zgjedhur që herë pas here të eskalojnë retorikën dhe tensionet si strategji komplementare ndaj dialogut. Ndërmarrësit etnik në të dy vendet (në qeveri dhe në opozitë) kanë shfrytëzuar këtë situatë për të akuzuar për tradhti ndaj interesave kombëtare.

Marrëveshja më e rëndësishme dhe më simbolike deri më tani u arrit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (IBM). Ashtu si edhe me marrëveshjet e tjera, pajtimi nuk është arritur në mirëbesim, dhe interpretimet e ndryshme

parandaluan arritjen e një marrëveshjeje të plotë (nënshkrimi i protokollit u arrit gjysmë viti më vonë). Kjo marrëveshje është e një rëndësie kritike për Prishtinën sepse e përkufizon kufirin me Serbinë dhe jep indikacion të gatishmërisë së Serbisë për të braktisur ambiciet për të aneksuar veriun e Kosovës.

E një rëndësie pothuajse aq të madhe, marrëveshja për përfaqësimin rajonal lejon Kosovën që të nënshkruajë marrëveshje në emër të vetë dhe në këtë mënyrë nuk ka nevojë më që të përfaqësohet nga UNMIK-u. Në të njëjtën kohë, e identifikuar me një yll pranë emrit të saj dhe një fusnotë që shpjegon interpretimet e ndryshme rreth statusit, Kosova pranon përfaqësim të pabarabartë dhe asimetrik.

Dritarja e mundësisë që kishte afruar Serbinë dhe Kosovën u mbyll në verën e vitit 2012. Zgjedhjet presidenciale dhe të përgjithshme në Serbi, mungesa e unitetit të BE-së, dhe mungesa e zbatimit të marrëveshjeve si dhe të progresit të pamjaftueshëm ishin arsye për mbyllje të mundësive. Megjithatë, dialogu tani edhe formalisht është përfshirë si kusht për integrimin e Kosovës dhe Serbisë në BE e kohëve të fundit janë përfshirë edhe normalizimi dhe integriteti territorial. Në këtë mënyrë, BE-ja ka filluar të përdorë ndikimin që t'i sjellë të dy palët me afër pajtimit duke i lëvizur nga qëndrimet e tyre fillestare që dallonin shumë nga njëra tjetra. Përderisa BE-ja nuk ka arritur të transformojë interesat e Prishtinës dhe Beogradit, ajo ka arritur t'i inkurajojë palët që së paku të shtiren si të sjellshme dhe të angazhohen me njëra-tjetrën në mënyrë konstruktive.

Suksesi do të varet nga fakti nëse të dy palët mund të pretendojnë që krahas dhe përmes bashkëpunimit me kundërshtarët e mëhershëm, i kanë shërbyer interesave të tyre vetanake. BE-ja duhet tu mundësojë elitave politike që t'i shohin përfitimet e angazhimit me palën tjetër në aspekt afatgjatë. BE-ja duhet të insistojë në zbatimin e marrëveshjeve të mëhershme, për të ruajtur kredibilitetin si

ndërmjetësues dhe që të krijojë një klimë të mirëbesimit për të rritur gjasat për sukses në raundet e ardhshme të dialogut politik. Udhëheqësit politikë në Prishtinë dhe Beograd, së bashku me BE-në, duhet në vazhdimësi t'i theksojnë përfitimet e prekshme në aspekt afatshkurtër dhe afatgjatë për shtetasit e tyre. Shqiptarët dhe serbët e Kosovës si dhe qytetarët e Serbisë do të përfitojnë nga një dialog parimor dhe i menduar mirë.

Hyrje

Ndërprerja e bisedimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit si rezultat i zgjedhjeve në Serbi në maj të vitit 2012 ka ofruar mundësi për të reflektuar mbi arritjet por edhe kufizimet e dialogut deri më tani.

Ky punim shqyrton performancën e dialogut të kaluar dhe vlerëson faktorët që duhen rikonsideruar në strukturën e procesit të ri. Është e rëndësishme të analizohet se s'i të shfrytëzohet më së miri dialogu dhe të krijohet një momentum për t'i zgjidhur çështjet e mbetura pezull.

Dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit i sponsorizuar nga BE-ja është zhvilluar për një vit (nga marsi 2011 deri në shkurt 2012) dhe ka qenë pjesërisht i suksesshëm në arritjen e disa marrëveshjeve konkrete. Me gjithë të metat e tij, dialogu ka qenë ndërmjetësimi më i suksesshëm në mes të Prishtinës dhe Beogradit në dy dekadat e fundit. Asnjë nga përpjekjet e mëhershme nuk ka sjell rezultate që janë pranuar nga të dy palët.

Një punim i mëhershëm i publikuar nga PER-Kosova dhe Qendra për Politika të Reja nga Beogradi, në dhjetor 2011 ka ardhur në përfundim që ky dialog ishte hera e parë që Serbia dhe Kosova janë pajtuar për ndonjë gjë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Po të ishin zbatuar të gjitha marrëveshjet, ky dialog madje do të mund të quhej historik.

Një numër faktorësh e shpjegojnë këtë sukses të pjesshëm. Së pari, bisedimet janë përqendruar në mënyrë eksplicite vetëm në aspekte teknike duke mënjanuar statusin apo çështjet simbolike. Së dyti, të dy palët kanë negociuar së paku me minimum të vullnetit të nevojshëm për të arritur ndonjë rezultat. Së treti, bisedimet janë zhvilluar në momentin e duhur, domethënë pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë dhe para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare e presidenciale në Serbi. Së katërti,

ndërmjetësimi i BE-së ka krijuar mundësinë për tu dhënë të dy palëve shpërblime për progres në bisedime, duke ndihmuar në tejkalimin e logjikës së shumë zero që ka shoqëruar të gjitha përpjekjet e mëparshme. E fundit, shtetet ndërmjetësuese kanë përdor kushtëzime më të fuqishme, duke ndihmuar që të ndryshohet perceptimin se çfarë fiton dhe çfarë humbin palët negociuese.

Këto bisedime nuk ishin sukses pa rezervë. Përpjekjet për të zbatuar marrëveshjet vetëm sa kanë vënë në pah dallimet në interpretim. Në kundërshtim me pritjet, dialogu deri më tani ndoshta e ka dëmtuar besimin në mes të palëve.

Gati çdo takim është përcjellë me eskalim të retorikës dhe tensioneve në terren. Raportimet dramatike mediale ilustronë se procesi përfshin çështje të interesit të lartë. Ndërmarrësit etnik e kanë shfrytëzuar konfliktin për të akuzuar negociatorët se po shesin interesat kombëtare.

Dialogu ka filluar të përmbush premtimin se mund të promovojë bashkëpunimin. Ende mbetet për të dëshmuar nëse ky dialog është i qëndrueshëm, që mund të përmirësojë jetën e qytetarëve të zakonshëm dhe t'i përafrojë të dy palët me Bashkimin Evropian.

Kronologjia e dialogut

Rezoluta e OKB-së (9 shtator 2010). Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miraton rezolutën A/RES/64/298 për nisjen e dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian.

Raundi i parë (7-8 mars 2011). Agjenda ka përfshirë kadastrën, regjistrin civil, CEFTA-n dhe vulat doganore/tregtia e lirë. Pak progres është arritur.

Raundi i dytë (28 mars 2011). Është diskutuar energjia elektrike dhe telekomunikacioni, dhe mbyllja e temave nga raundi i parë si regjistri civil, kadastrat, vulat doganore/tregtia e lirë. Pak progres është raportuar në çështjen e furnizimit me energji elektrike.

Raundi i tretë (5 prill 2011). Është diskutuar liria e lëvizjes (dokumentet personale dhe ato të udhëtimit, sigurimi i veturave, lejet e vozitjes dhe tabelat e regjistrimit), njohja reciproke e diplomave, dhe u diskutuan të gjitha temat nga dy raundet e para.

Raundi i katërt (17-18 maj 2011). Çështjet e personave të zhdukur dhe trashëgimisë kulturore u diskutuan, si dhe vazhdoj diskutimi mbi njohjen reciproke të diplomave. Asnjë marrëveshje nuk është arritur për temat e hapura.

Raundi i pestë (2 korrik 2011). U arritën tri marrëveshje: për lirinë e lëvizjes; mbi shkëmbimin e regjistrave civil; dhe në njohjen reciproke të diplomave universitare (marrëveshje në parim).

Raundi i gjashtë (2 shtator 2011). Palët janë pajtuar që vulat doganore të Kosovës të kenë mbishkrimin “Doganat e Kosovës” pa ndonjë simbol shtetëror. Është arritur një marrëveshje për kthimin e kadastrave. Po ashtu janë diskutuar edhe telekomunikacioni dhe diplomat universitare, mirëpo nuk është arritur ndonjë marrëveshje.

Raundi i shtatë (21-22 nëntor 2011). Janë diskutuar njohja e diplomave dhe pikat e kalimit kufitar—më formalisht, integrimi i menaxhuar i kufirit (IBM) në mes të Kosovës dhe Serbisë. Bashkëpunimi rajonal, telekomunikacioni dhe energjia elektrike u trajtuan gjithashtu. Palët janë pajtuar që Asociacioni Evropian i Universiteteve do t'i verifikoj dhe certifikoj diplomat e lëshuara nga universitetet e secilës palë për përdorimin e palës tjetër.

Raundi i tetë (30 nëntor – 2 dhjetor 2011). U arrit marrëveshje mbi menaxhimin e kufirit. Nuk është arritur marrëveshje mbi përfaqësimin rajonal të Kosovës; u vazhdua diskutimi mbi telekomunikacionin dhe energjinë elektrike.

9 dhjetor 2011, Këshilli i Bashkimit Evropian shtyu marrjen e vendimit për statusin e kandidatit të Serbisë për Bashkimin Evropian deri në mars 2012, me ç'rast disa shtete anëtare kanë bërë referenca specifike për situatën në veri.

26 dhjetor, ka filluar zbatimi i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes.

Raundi i nëntë (22-25 shkurt 2012): Ekipet e Prishtinës dhe Beogradit janë pajtuar mbi bashkëpunimin dhe përfaqësimin rajonal, më saktësisht që Kosova të përfaqësohet në takimet rajonale me përcaktimin „Kosovo*“, me një fusnotë përkatëse. Palët gjithashtu finalizuan një protokoll teknik për zbatimin e marrëveshjes së integritetit të menaxhuara të kufirit.

29 shtator, Qeveria e Kosovës miratoi protokollin teknik të IBM-së, e cila do të zbatohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Që nga marsi 2012, Prishtina dhe Beogradi nuk janë takuar.

Shqyrtim i çështjeve në diskutim

Është ironik fakti që pothuajse të njëjtat çështje të diskutuara përgjatë viteve 2011 dhe 2012 kanë qenë temë e tentimeve të mëparshme për dialog gati një dekadë më parë.

Me 3 mars [2003], Steiner kishte deklaruar që një grup ministrash të Serbisë do të ftoheshin për të marr pjesë në bisedime me homologët e tyre kosovarë. Në një letër dërguar kryeministrit serb Zoran Gjingjiq dhe zëvendësit të tij Nebojsa Çović, Steiner kishte identifikuar çështjet e bashkëpunimit për njohjen e tabelave të regjistrimit të veturave, letërnjoftimeve, dokumenteve të udhëtimit, përgjegjësitë për sigurimin social, energjinë, tregtinë, transportin dhe kthimin e regjistrave të pronës.¹

Pas gati dhjetë viteve, shtatë marrëveshje u arritën pas nëntë raundesh të diskutimit dhe mbajtjes së disa takimeve të grupeve punuese në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Këto marrëveshje përfshijnë një sërë çështjesh të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë dhe në bashkëpunimin reciprok.

Robert Cooper, Këshilltar në Shërbimin e Jashtëm Evropian dhe ndërmjetësuesi i BE-së për dialogun, ka qenë personi më entuziast për bisedimet, duke u shprehur shumë herë se rezultatet e bisedimeve i kanë tejkaluar pritjet e para një viti.

Megjithatë, zbatimi i këtyre marrëveshjeve në vazhdimësi ka qenë kundërthënës. Prishtina insiston që nuk do të marr pjesë në dialog përderisa këto marrëveshje nuk zbatohen. Në anën tjetër, Serbia mban qëndrimin që këto marrëveshje po zbatohen mirëpo thekson interpretim të ndryshëm apo vështirësi teknike.

Pas analizimit të nivelit të zbatimit si dhe deklarimit të pozicioneve nga të dy palët, çështjet që po diskutohen mund të kategorizohen në dy grupe:

- ⇒ Marrëveshje të arritura dhe me zbatim së paku të pjesshëm dhe
- ⇒ Interpretime të debatueshme dhe përgjithësisht të pazbatuara.

Marrëveshje të arritura dhe të zbatuara pjesërisht

Nga shtatë marrëveshjet e arritura, vetëm tri prej tyre mund të konsiderohen si marrëveshje me pajtueshmëri të plotë të palëve dhe që së paku pjesërisht janë zbatuar. Këtu përfshihen marrëveshjet për tregti të lirë, diploma universitare dhe librat kadastral.

Tregtia e lirë

Deri në arritjen e marrëveshjes për tregti të lirë, UNMIK-u ka qenë nënshkruar i marrëveshjes së CEFTA-s në emër të Kosovës, dhe për qëllime tregtare Kosova ka përdorur vula me mbishkrimin „Doganat e UNMIK-ut.“ Kosova nën UNMIK-un ka qenë pjesë e CEFTA-s mirëpo ka qenë e dëmtuar për shkak të mungesës së lirisë së lëvizjes, veçanërisht për mjetet transportuese me tabela të regjistrimit „KS“. Kjo marrëveshje, në mes të tjerash, e rregullon formën si Kosova zhvillon biznes me Serbinë dhe me shtetet e tjera në rajon.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, autoritetet e Kosovës i ndërruan vulat doganore duke vendosur mbishkrimin „Doganat e Kosovës.“ Autoritetet e BE-së e pranuan këtë ndryshim dhe UNMIK-u deklaroi që kjo vulë nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, Beogradi nuk e pranoi këtë, duke e ashpërsuar më tej tregtinë në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kjo çështje u ngrit që në takimet e para në Bruksel, mirëpo nuk u arrit asnjë marrëveshje. Me 20 korrik 2011, Qeveria e

Kosovës mori vendimin për të zbatuar masat e reciprocitetit tregtar me Serbinë që përfundoi në mos-njohjen e vulave doganore të Serbisë. Ky vendim si dhe operacioni i forcave speciale të Policë së Kosovës për ta zbatuar këtë vendim, e shtuan presionin për të përfunduar arritjen e marrëveshjes që edhe ashtu ishte në fazat e saj përfundimtare.

Marrëveshja e arritur me 2 shtator 2011, konfirmoi përdorimin e termit „Doganat e Kosovës“ dhe u bënte thirrje palëve që të ndërmerrnin çdo veprim të mundshëm për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave dhe dërgimin e konfirmimit në CEFTA lidhur me këtë. Kjo marrëveshje është perceptuar në forma të ndryshme nga palët përkatëse. Përderisa Kosova dhe shtetet kryesore perëndimore e mirëpritën marrëveshjen, Beogradi ka qenë më pak pozitiv në perspektivën e vet duke qenë se ky veprim është përballur me kritika të ashpra sidomos nga komunat veriore.

Kjo marrëveshje i ka hapur dyert për tregti të lirë në mes të dy shteteve. Për më shumë, ajo i ka ndihmuar Kosovës që të fillojë heqjen e përdorimit të UNMIK-ut si palë në raportet e jashtme tregtare. Më tutje, Kosova planifikon që të heq fare UNMIK-un nga të gjitha dokumentet doganore, mirëpo marrëveshja ka shtrirje të kufizuara gjeografike (e kufizuar vetëm në shtetet anëtare të CEFTA-s). Po ashtu, largimi i UNMIK-ut megjithatë mund të ketë ndikim negativ në shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën e që nuk janë anëtare të CEFTA-s.

Diplomat universitare

Pas pavarësimit të Kosovës, institucionet e arsimit të lartë në vend filluan zëvendësimin e logos dhe mbishkrimit të UNMIK-ut dhe lëshimin e diplomave me logon „Republika e Kosovës“ dhe simbolet shtetërore. Këto diploma nuk u njohën nga autoritetet në Beograd dhe qindra studentëve shqiptarë nga Serbia (veçanërisht nga Presheva, Bujanoci

dhe Medvegja) iu pamundësua vazhdimi i studimeve apo punësimi në Serbi.

Si rezultat, këta studentë shkurajoheshin që të studiojnë në Kosovë dhe u detyruan të transferojnë studimet në Maqedoni apo Shqipëri. Në Kosovë, u miratuan masa të përkohshme për të zbutur këtë gjendje, përmes shërbimeve jo-zyrtare me ç'rast UNMIK-u lëshonte certifikata që konfirmonin që diplomat ishin të vlefshme.

Çështja e njohjes së diplomave universitare është trajtuar në dy raunde të dialogut teknik. Një marrëveshje e vullnetit të mirë ishte arritur me 2 korrik 2011 ku palët u zotuan për gjetjen e një zgjidhjeje të bazuar në praktikat më të mira Evropiane. Marrëveshja përfundimtare u arrit me 21 nëntor 2011 ku parashihej një rol i ndërmjetësuesit për Asociacionin Evropian të Universiteteve (AEU). Asociacioni morri përsipër verifikimin dhe certifikimin e diplomave, transkripteve apo dokumenteve të tjera shtesë të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë apo Serbi e që do të përdorehin nga pala tjetër.

Marrëveshja theksonte që BE-ja do të bëjë përpjekje për t'i zbatuar konkluzionet e marrëveshjes, të cilat siç u përmend ia besuan Asociacionit Evropian të Universiteteve hartimin dhe verifikimin e dokumenteve të nevojshme. Këto dokumente më pastaj do të dërgohen në komitetin e ekspertëve të AEU-s për certifikim. BE-ja ka kontraktuar SPARK-un për bashkëpunim akademik në Kosovë, mirëpo një institucion i tillë nuk është kontraktuar ende për në Serbi.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka marrë kohë, derisa janë vendosur marrëdhëniet kontraktuale me SPARK-u dhe derisa qeveria në Serbi ka miratuar një rregullore që mundëson një mënyrë speciale të njohjes së kredencialeve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.²

Zbatimi praktik i kësaj marrëveshjeje do të testohet në terren pasi që numri i parë prej afër 70 diplomash të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë certifikuar me 26 korrik 2012.³ Mbetet ende të shihet nëse këto diploma të certifikuara do të pranohen në Serbi për punësim apo vazhdim të studimeve.

Kadastra

Marrëveshja për regjistrat kadastral është arritur me 24 shtator 2011 dhe zbatimi i saj tashmë ka filluar. Kjo marrëveshja ka paraparë dorëzimin e kopjeve të skanuara të regjistrave kadastral nga Serbia në institucionet përkatëse në Kosovë dhe krijimin e një institucioni për ndërmjetësim. Të dy palët janë pajtuar që këtë marrëveshje ta zbatojnë në mënyrë të sinkronizuar.

Një grup punues tre palësh është krijuar dhe përbëhet nga institucionet përgjegjëse nga Kosova dhe Serbia dhe kryesohet nga EULEX-i. Pas tri takimesh të mbajtura, me 4 prill 2012 autoritetet e Kosovës pranuan listën finale të dokumenteve të marra gjatë luftës në Kosovë e të cilat do të kthehen gradualisht në Kosovë.

Puna praktike në këtë proces është shumë e komplikuar dhe merr shumë kohë. Kjo kërkon që Kosova të miratojë Ligjin për Agjencinë e Pronës së Kosovës (APK). Ligji gjithashtu përfshin edhe ristrukturimin e kësaj agjencie përmes përfshirjes së mekanizmave të verifikimit dhe ndërmjetësimit ku në mes të tjerash agjencia do të riemërohet Agjencia e Kosovës për Verifikim të Pronave (AKVP). Përmes procedurave normale legjislative, miratimi i një ligji të tillë do të zgjas së paku një gjysmë viti. Kjo procedurë është dashur të kryhet deri në mesin e vitit 2012, mirëpo ligji ende është në procedurë të miratimit nga Kuvendi i Kosovës.

Serbia duhet të fillojë skanimin e regjistrave dhe dorëzimin e tyre te autoritetet e EULEX-it dhe ato të Kosovës. Serbia ka refuzuar të kryej këtë obligim deri sa Kosova të aprovojë ligjin e sipërpërmendur. Ajo po ashtu ka kërkuar asistencë financiare nga BE-ja në mënyrë që të angazhojë personel dhe pajisje shtesë. Një hap dhe shenjë inkurajuese ka qenë miratimi i një rregulloreje të veçantë nga Qeveria e Kosovës e cila e rregullon procesimin e të dhënave kadastrale që gjenden në Serbi.⁴

Arsye tjetër pse zbatimi i marrëveshjes për kadastrën është një proces shumë i gjatë është se parashih skanime të shumta. Verifikimi, ndërmjetësimi dhe vendimet përfundimtare nga Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu do t'i marrin edhe shumë më shumë kohë këtij procesi. Edhe pse palët janë pajtuar dhe sistemi ka filluar të funksionojë, është e domosdoshme fryma e dialogut dhe e vullnetit politik për ta përfunduar këtë detyrë.

Interpretimet kundërthënëse dhe mungesa e zbatimit

Disa nga marrëveshjet më të rëndësishme të arritura gjatë këtij dialogu nuk janë zbatuar në mënyrë të duhur. Këto marrëveshje përfshijnë (a) lirinë e lëvizjes, (b) regjistrin civil, (c) menaxhimin e integruar të kufirit (IBM), dhe (d) bashkëpunimin rajonal. Këto marrëveshje përfshijnë disa nga rezultatet më të rëndësishme të dialogut dhe zbatimi i plotë i tyre do të kishte një ndikim të madh në marrëdhëniet në mes të dy vendeve.

Liria e lëvizjes

Që nga viti 1999, qytetarët e Kosovës nuk kanë mundur të udhëtojnë në Serbi apo përmes Serbisë për shkak që Beogradi nuk i kishte pranuar dokumentet e lëshuara nga UNMIK-u. Që nga viti 2008, autoritetet e Serbisë nuk

pranonte asnjë dokument të lëshuar nga Republika e Kosovës, përfshirë pasaportat, letërnjoftimet, patentat e shoferit dhe targat e të veturave. Prishtina i ka pranuar të gjitha dokumentet e lëshuara nga Beogradi dhe ka toleruar edhe dokumentet e lëshuara nga komunat paralele të vendosura në Serbi.

Liria e lëvizjes ka qenë temë e ngritur disa herë gjatë raundeve të dialogut dhe në të njëjtën kohë ka qenë edhe ndër temat më të nxehta. Beogradi ka qëndruar mbrapa pozicionit politik që pranimi i pasaportave të Kosovës do të nënkuptonte *de-facto* njohjen e Kosovës.

Kompromisi është gjetur pas përpjekjeve të vështira diplomatike nga ndërmjetësi i BE-së, i përkrahur nga mekanizmat e tjerë të BE-së. Zgjidhja përbëhet nga 11 pika të cilat kanë vendosur një regjim të ri të udhëtimit në mes të dy shteteve. Serbët dhe kosovarët tani mund të kalojnë kufirin duke përdorur vetëm letërnjoftimet.

Marrëveshja është arritur me 2 korrik 2012 dhe pas disa vonesave ka hyrë në fuqi me 26 dhjetor 2011. Vonesat ishin shkaktuar nga bllokadat e rrugëve në veri të Kosovës si dhe vështirësitë politike me të cilat u përball qeveria në Beograd. Edhe pse ky proces është rregulluar ligjërisht, vështirësitë janë hasur në terren dhe ende ka pengesat praktike. Shpenzimet e larta të sigurimit, radhët e gjata në kufirin Kosovë-Serbi dhe arrestimet e motivuara politikisht gjatë kalimit të kufirit për në Serbi e kanë mbajtur udhëtimin në nivel shumë të ulët.

Tri nga gjashtë pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të hapura për qytetarët e Kosovës. Shumica e pikave kufitare në mes të Serbisë dhe shteteve të tjera nuk lejohen për kalim transit për kosovarët, lejohen vetëm në pikat e mëdha kufitare për kalim në Hungari dhe Kroaci. Pikat tjera kufitare për në Bullgari, Maqedoni, Rumani dhe aeroporti i

Beogradit nuk mund të përdoren për udhëtim dhe asnjë masë nuk është ndërmarrë për këtë çështje nga atëherë.

Marrëveshja ka rikthyer tabelat e regjistrimit „KS“ të kohës së UNMIK-ut të cilat ishin larguar nga përdorimi, të cilat mund të përdoren lirshëm për udhëtim në Serbi. Mjetet transportuese që përdorin tabelat e reja „RKS“ duhet t'i zëvendësojnë ato në pikën kufitare me tabela të përkohshme serbe.

Një skemë e sigurimeve është në funksion në të dy anët mirëpo është shumë e shtrenjtë. Sigurimi i automjeteve në kufi kushton mbi 100 euro në muaj për të udhëtuar në Serbi, ndërsa 60 euro për të qëndruar 14 ditë në Kosovë, rrethana që dëshmojnë qartë se nuk është trajtuar interesi i qytetarëve të zakonshëm.

Megjithëse kjo skemë është vendosur si e përkohshme nuk ka shenja që do të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Kosova dhe Serbia duhet të pajtohen që t'i ulin çmimet deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme që mund të ndodh kur Kosova të bëhet anëtare e Byrosë së Kartonit të Gjelbërt, si anëtare e pavarur apo përkohësisht përmes ndonjë shteti të tretë.

Që nga gushti i vitit 2011, veriu i Kosovës ka qenë i bllokuar nga barrikatadat në rrugë të vendosura nga udhëheqësit serbë në veri, që në fillim e kishin përkrahjen nga Beogradi.⁵ Barrikatadat e kanë paralizuar përdorimin e dy pikave kufitare veriore (pikat 1 dhe 31) për popullatën e përgjithshme dhe çdo përpjekje për largimin e tyre ka hasur në rezistencë dhe dhunë. Qytetarët e zakonshëm serbë nuk mund t'i përdorin pikat zyrtare kufitare ndërsa shqiptarët ndihen të rrezikuar të përdorin këto rrugë. Barrikatadat po ashtu kanë dobësuar tregtinë e lirë dhe kanë krijuar kanale alternative për transport.

Kjo marrëveshje është interpretuar në forma të ndryshme nga të dy palët. Prishtina mbron mendimin që ka hyrë në një

marrëveshje që përfshin të gjithë territorin e Kosovës dhe të gjithë banorët e saj përderisa Beogradi konsideron se marrëveshja përfshin vetëm territorin në jug të lumit Ibër.

Interpretimi i Beogradit për këtë marrëveshje është qartazi për konsum të brendshëm përderisa marrëveshja për lirinë e lëvizjes është shumë e qartë. Paragrafi i shtatë i marrëveshjes thekson që „të gjithë pronarët e veturave me banim të përhershëm në Kosovë do të përdorin tabelat e regjistrimit me inicialet ‘RKS’ apo ‘KS’“ dhe ky qëndrim është përforcuar edhe nga zëdhënësja e EULEX-it e cila ka konfirmuar që marrëveshja “përfshin të gjithë territorin e Kosovës, duke përfshirë edhe veriun.”⁶

EULEX-i ka shpërndarë fletushka për të informuar qytetarët serbë në veri për detajet teknike të marrëveshjes së arritur në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe po ashtu i ka informuar ata që kjo përfshin edhe ri-regjistrimin e automjeteve të tyre dhe marrjen e dokumenteve të lëshuara në Kosovë.

Kryesuesi i ekipit negociator të Serbisë, Borislav Stefanoviq, e ka quajtur këtë shkëlqje të rëndë të marrëveshjes së arritur në Bruksel, duke mos u mbështetur në ndonjë dokument që ishte nënshkruar.⁷ Ish Ministri i Serbisë për Kosovë dhe Metohi, Goran Bogdanoviq, nuk e ka sfiduar marrëveshjen por i ka sfiduar afatet e përcaktuara e që kanë të bëjnë me ri-regjistrimin e automjeteve, duke përfshirë aplikimin për dokumente si letërnjoftim apo për leje të vozitjes.⁸ Për shkak të rezistencës së madhe, afati është shtyrë disa herë dhe zbatimi i afateve në veri nuk duket të jetë më çështje prioritare.

Kryetari ‘paralel’ i Komunës së Zubin Potokut, Slavisha Ristiç, ka deklaruar që fletushkat nuk lënë vend për dyshime dhe e kishte akuzuar Stefanoviqin për dy interpretime të ndryshme “një për publikun në Serbi dhe tjetrën për qytetarët në veri, të cilët ai mundohet t’i bindë se kjo nuk do

të vlente edhe për ta. Kjo nuk është e shkruar në marrëveshje dhe EULEX duhet t'i përmbahet asaj.”⁹ Mediat në Serbi kanë theksuar që edhe serbëve në veri u është thënë që duhet t'i ndërrojnë tabelat e regjistrimit në „KS“ apo „RKS“ deri me 1 qershor.¹⁰

Regjistri civil

Marrëveshja për regjistrin civil është arritur me 2 korrik 2011. Ajo parasheh kthimin e kopjeve të regjistrimit civil të marra nga autoritetet e Serbisë në vitin 1999 dhe certifikimin e tyre nga EULEX-i. Ky proces është më pak i ndërlikuar meqenëse nuk kërkon miratimin e legjislacionit apo krijimin e strukturave të reja, por vetëm skanimin e tyre nga autoritetet serbe, certifikimin nga EULEX dhe dorëzimin e tyre te institucionet në Prishtinë.

Mbi 200 kopje të certifikuara (1.7% nga gjithsejt 14.000 libra) u janë dorëzuar Prishtinës deri më tani. Në fillim të dhjetorit, libri i parë origjinal i regjistrimit civil (nga komuna e Lipjanit) është certifikuar nga EULEX-i si i vërtetë krahasuar me origjinalin dhe i është dorëzuar autoriteteve të Lipjanit.

Ky proces është i gjatë veçanërisht duke pasur parasysh ritmin e ngadalshëm me të cilin ka filluar. Ngjashëm sikur edhe me regjistrat kadastral, një grup punues tre-palësh i udhëhequr nga EULEX-i është formuar, me qëllim të lehtësimit të këtij procesi. Megjithatë, deri në korrik 2012 shumë pak është bërë në drejtim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje e cila duket se do të zgjas tepër shumë.

Menaxhimi i integruar i kufirit (IBM)

Me 2 dhjetor 2011, palët u morën vesh për menaxhimin e integruar të kufirit. Ata u zotuan që sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, gradualisht të kalime kufitare të përbashkëta dhe me menaxhim të integruar, duke u bazuar

në praktikat më të mira evropiane. Vendkalimet kufitare të përbashkëta (Serbia i quan 'kufij administrativ) do të themelohen së bashku me përcaktimin e vijave ndërmjet dy vendeve. Kjo kërkon që BE-ja të financojë themelimin gradual të ndërtesave të përbashkëta dhe që EULEX-i të përfshihet në marrëveshje dhe protokolle. Në aspektin simbolik, kjo ka qenë marrëveshja më e rëndësishme sepse ka qenë një provim i madh nëse Serbia ka braktisur ambiciet për ndarje të Kosovës si një nga qëllimet kryesore politike.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje përballet me dy vështirësi të mëdha të cilat lidhen me protokollin e përfunduar në raundin e 9-të të bisedimeve (24 shkurt 2012), por i cili ende nuk është nënshkruar. Së pari, autoritetet e Prishtinës dhe në një farë mase edhe BE-ja, e shohin mungesën e vullnetit të Serbisë për ta nënshkruar protokollin si një pengesë për zbatimin e saj. Së dyti, përderisa protokollin nuk është nënshkruar (fund të shtatorit shtator), BE-ja nuk do të ofronte asnjë asistencë financiare për zbatimin e saj.

Protokollin ofron një dimension operacional të marrëveshjes dhe ka për qëllim që të mundësojë që agjencitë dhe organet relevante t'i përgatisin të gjitha çështjet praktike duke përfshirë vendndodhjen e pikëkalimeve kufitare, praninë e saktë të autoriteteve (doganat, policia dhe agjencitë veterinarë dhe fitosanitare), buxhetin dhe burimin e financave, përdorimin e uniformave dhe shenjave dalluese si dhe procesimin dhe shkëmbimin e informatave¹¹. Liderët e lartë të BE-së kanë paralajmëruar që zbatimi i marrëveshjeve për menaxhimin e integruar të kufirit dhe përfaqësimi rajonal janë një proces jo i lehtë dhe mund të zgjasin "nga një muaj e deri në disa vite"¹².

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rajonal

Marrëveshjet e arritura në shkurt të vitit 2012 rregullojnë përfaqësimin e Kosovës në forumet rajonale. Para arritjes së kësaj marrëveshjeje, UNMIK-u e ka lehtësuar pjesëmarrjen

e Kosovës në takime të ndryshme të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar¹³.

Kjo marrëveshje është konsideruar si më e rëndësishmja sepse e ka zvogëluar nevojën e përfaqësimit të Kosovës me UNMIK-un si ndërmjetës. Kjo marrëveshje megjithatë nuk e anashkalon përgjithësisht UNMIK-un meqenëse ai e ruan diskrecionin që të vendos nëse do të marrë pjesë në takime të caktuara. Megjithatë, „duke pasur parasysh elementet e marrëveshjes së arritur dhe pas konsultave me palët e interesit, UNMIK ka arritur në përfundim që nuk është e nevojshme të marr pjesë në takime të caktuara“¹⁴.

Kosova ka fituar të drejtën që të nënshkruajë marrëveshje në emër të saj, që shihet si depërtimi më i rëndësishëm për përfaqësimin e drejtpërdrejtë të Kosovës ndërkombëtarisht. Por marrëveshja megjithatë ka qenë nën nivelin për të cilin shpresohet, për „një formë e pranuar reciprokisht që do të lejonte Kosovën të bëhej pjesë e disa organizatave dhe të avanconte raportet me BE-në duke përfshirë edhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit“¹⁵. E kundërta megjithatë u vërtetua në fillim të tetorit, sepse është pikërisht fusnota që mundëson lansimin e bisedave për marrëveshje për MSA-në.¹⁶

Marrëveshja përcakton se delegacionet e Kosovës do të përfaqësohet me emërtimin „Kosovo*“. Ylli shënon fusnotën e bashkëngjitur në dokumente (si p.sh. agjenda) që shënon:

„Ky emër është pa paragjykime për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës“.

Mënyra e saktë e përdorimit të kësaj fusnote nuk është qartësuar në mënyrë eksplicite dhe interpretimet e ndryshme kanë penguar pjesëmarrjen e përbashkët të Beogradit dhe Prishtinës në takimet rajonale. Beogradi ka

insistuar që i gjithë teksti i fusnotës të paraqitet pranë emrit menjëherë pas “Kosovo”, përderisa Prishtina dhe ndërmjetësi i BE-së kanë argumentuar që duhet pranë emrit mund të përdoret vetëm ylli. Kjo mosmarrëveshje më së shumti ka bërë që të mos marr pjesë Beogradi në forumet rajonale, por gjithashtu kishte raste kur Prishtina nuk është ftuar nga organizatorët e ndonjë forumi.

Qeveria e Serbisë i ka udhëzuar të gjithë përfaqësuesit e saj në forume ndërkombëtare që të lexojnë një deklaratë e cila thotë që Kosova është krahinë e Serbisë. Për këso lloj rastesh, Kosova i ka udhëzuar përfaqësuesit e saj të përgjigjen duke përmendur që Kosova është republikë, anëtarësinë e Kosovës në organizata ndërkombëtare si dhe numrin e njohjeve ndërkombëtare të saj¹⁷.

Këto interpretime kundërthënëse kanë penguar Prishtinën dhe Beogradin që të ulen rreth të njëjtës tryezë që nga marsi i vitit 2012. Shqetësimi është më serioz sesa vetëm pesha e marrëveshjeve rajonale dhe sinjalizon „mungesë të mekanizmave për të siguruar zbatimin e marrëveshjeve“¹⁸. Qeveria e re e Serbisë ka dhënë sinjale për një interpretim të ndryshëm të fusnotës i cili lejon që të dy vendet të marrin pjesë në takime. Tani Serbia duket e kënaqur përderisa Kosova të përfaqësohet si „asimetrike“.

Lidershipi i Serbisë është zotuar që do të respektojë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Kosovën nga qeveria e mëparshme. Ivica Daçiç, Kryeministri i Serbisë, ka deklaruar se ai nuk do të udhëheq një Serbi të parajsës, por do të udhëheq një Serbi e cila do të ndjekë politika realiste. Duke ndryshuar qëndrimin e tij, Daçiçi është shprehur se pjesëmarrja e Kosovës në takime është në interes të Serbisë¹⁹.

Kjo formulë ka potencial „që t'i lejoj Kosovës hyrjen në organizata dhe të avancojë raportet e saj me BE-në duke përfshirë edhe një Marrëveshje të plotë të Asociim

Stabilizimit²⁰. Për fat të keq, ajo ka edhe potencial që të lë Kosovën për një kohë të gjatë në mesin e gjysmë shteteve, duke krijuar kështu një *status quo* të re.

Një vit i shtirjes dhe dialogut të detyruar

Dialogu ka të bëjë me gjetjen e momentit të duhur, dhe gjatë vitit 2011 Kosova e Serbia e shfrytëzuan këtë mundësi deri diku. Dritarja e mundësisë që afrooi paksa Serbinë dhe Kosovën u mbyll në 2012 për shkak të disa faktorëve: (a) Serbia organizoi zgjedhje presidenciale në veri, (b) BE-ja dëshmoi një mungesë të unitetit e cila e dobësoi fuqinë e saj ndërmjetësuese, (c) marrëveshjet e arritura nuk zbatoheshin, (d) disa tema dështuan të përfshihen në dialog (telekomunikimi, energjia) dhe (e) veçanërisht në Kosovë, u krijua perceptimi se “karotat” e BE-së po i shpërblenin palët dialoguese në mënyrë të pabarabartë.

Përtej shumës zero por pa frymë dialogu

Bisedimet nuk u motivuan nga fryma e dialogut e as nuk krijuan një atmosferë pozitive rreth tij. Normalisht mungesa e besimit në fillim të një procesi të tillë nuk është i pazakonshëm meqenëse përpjekjet për dialog bëhen në mes të palëve që kanë qenë të përfshira në veprime agresive kundër njëri tjetrit. Sidoqoftë, qëllimi i një dialogu është krijimi i një klime të bashkëpunimit dhe krijimi i besimit.

BE-ja ka shpërblyer të dy palët për progresin në bisedimet Kosovë-Serbi, megjithëse marrëveshjet ende pritet të zbatohen. Në fillim të marsit, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian votuan për t'i dhënë Serbisë statusin e kandidatit. Në fund të marsit, Komisionari Evropian për Zgjerim edhe formalisht nisi studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të BE-së dhe Kosovës.

Këto dy arritje u shënuan edhe si zhvillimet kryesore pozitive në aspektin politik që rezultuan nga dialogu i sponsorizuar nga BE-ja²¹. Siç ka deklaruar edhe një zyrtar i lartë i BE-së, pa motivime konkrete për palët nga BE-ja, pa

dyshim që të dy vendet thjesht do të ngeleshin në pozicionet e tyre të ngurta përgjithmonë²².

Në një punim tjetër, dialogu ishte emëruar si një garë bukurie²³. Në atë punim është argumentuar që palët nuk janë përfshirë sinqerisht në dialog por thjesht kanë bërë një gjë të tillë për hatër të BE-së dhe nën presion. Negociatorët nuk janë angazhuar që të bindin palën tjetër për qëndrimet e tyre por thjesht që të ndikojnë vlerësimin e ndërmjetësit të jashtëm. Në këtë mënyrë, me gjithë dobësinë e ndërmjetësuesit, roli i BE-së në këtë rast është konsideruar shumë i fuqishëm për shkak të „karotave“ shpërblyese që mund t'i jepte. Për të dy palët ka qenë esenciale që të fitojnë emërtimin e të qenit „konstruktiv“.

Për fat të keq, negociatorët nuk kanë përcjell të njëjtin vullnet të mirë në vendet e tyre përkatëse. Në vend që të mundohen që të ndryshojnë tendencat populiste në rritje e sipër, ata thjesht i kanë shfrytëzuar ato. Ky mjedis i shumë zero²⁴ ka bërë të pamundshëm për negociatorët që të ruajnë reputacionin e tyre në raport me publikun në shtëpi por edhe me shtetin tjetër. Besimi i përgjithshëm apo publik ka qenë që nëse ndokush i qaset palës tjetër, atëherë konsiderohet tradhtar e nëse ruan linjën dhe gjuhën e ashpër, i shërben interesave nacionale. Jo vetëm që kjo nuk qëndron, por për të qenë të suksesshme, bisedimet e ardhshme duhet të transformojnë këtë perceptim ku interesi vetanak definohet vetëm duke marr parasysh kundërshtimin e palës tjetër.

Me gjithë mungesën e suksesit, BE-ja ka arritur të përfshijë dialogun si kusht formal për integrim në BE. BE-ja ndoshta nuk ka arritur t'i transformojë interesat vetanake të palëve por ka arritur që të vendos një karrem që t'i inkurajojë palët që së paku të shtiren me një lloj mirësjelljeje. Shtirja e të qenit të mirësjellshëm me njëri tjetrin për një kohë të gjatë ndoshta edhe mund t'i bëjë palët që të mësohen me këtë e

mund të ndihmojë në transformimin e dinamikës së ngadaltë.

Transformimi i interesit personal si mënyrë vlerësimi

Përfundimisht suksesi do të varet nga fakti nëse palët do të mund të pretendojnë që i kanë shërbyer interesave të shtetit të tyre përmes bashkëpunimit me armikun e tyre të mëparshëm. Me gjithë imazhin pro-dialogut, elitat politike të të dy shteteve duhet të ndalojnë së menduari se dobësia e palës tjetër është thelbësore për interesin e vet. Përderisa Serbia të perceptohet si kërcënim për Kosovën dhe anasjelltas, të dy palët do të shohin fuqizimin e tyre vetëm në kurriz të palës tjetër²⁵. Në momentin që tejkalohen vështirësitë emocionale të angazhimit me palën tjetër dhe atëherë kur rezultatet shihen prej një perspektive strategjike më afatgjate, Kosova edhe Serbia do të mund t'i shërbenin interesave të tyre përmes bashkëpunimit me njëri tjetrin.

Ndërmjetësimi i suksesshëm duhet të ndërtojë një raport të mirë dhe funksional, mirëpo ky proces ka dështuar deri më tani. Raportet e mira të bashkëpunimit dhe kanalet e drejtpërdrejta të komunikimit nuk janë thjesht një efekt anësor i dialogimit por një qëllim i rëndësishëm më vete. Prandaj është shumë i rëndësishëm sigurimi i zbatimit të marrëveshjeve si mënyra më e mirë e krijimit të klimës së mirëbesimit. Kjo pastaj mund të sjell më shumë dialogim dhe mund të transformojë raportet në mes të Prishtinës dhe Beogradit nga konflikti në bashkëpunim.

A sjellë shtirja përafrim?

Me përqendrimin në aspekte teknike, dialogu nuk ka mëtuar arritjen e pajtimit për pikëvështrimet konfliktuoze që përbejnë bazën e pozicioneve të palëve. Studiuesi ligjor Cas Sunstein i ka quajtur këto „marrëveshje teorike të pakompletuara“ ku palët arrijnë marrëveshje pa u pajtuar së

pari për premisat fundamentale²⁶. Kjo megjithatë mund të ketë epërsinë e zvogëlimit „të kostos politike të mosmarrëveshjeve që zgjasin përgjithmonë“²⁷ por, në të njëjtën kohë, është një kompromis i arritur mbi baza jo stabile. Kjo vlen veçanërisht në raport me „marrëveshjen për fusnotën“, pra asaj rreth përfaqësimit rajonal. Vetë udhëheqja e BE-së e ka pranuar që nuk është specifikuar nëse ylli do të përdoret në shënjesit e emrave apo vetëm në dokumente zyrtare²⁸.

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Baronessa Catherine Ashton, e ka quajtur marrëveshjen për përfaqësimin rajonal „historike“. Ky është një ekzagjerim për shkak se të gjitha problemet ende janë të hapura (zgjidhja e të cilave mbase do të mund të jepte kualifikimin e marrëveshjes si historike): mungesa e njohjes nga Serbia, Rusia dhe pesë vendet e BE-së, veriu etj. Një zyrtar ndërkombëtar që ka punuar në Kosovë ka deklaruar se nëse fusnota do të ishte zgjidhja, atëherë problemi që e ka zgjidhur nuk ka qenë aq i rëndë²⁹.

Duke i pasur në konsideratë dallimet aktuale të pozicioneve në mes të Prishtinës dhe Beogradit këto „marrëveshje teorike të pakompletuara“ mund të jenë zgjidhja më e përshtatshme për momentin. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet që ato nuk i adresojnë dallimet thelbësore të pozicioneve. Si rezultat, mos zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve thelbësore mund të rrezikojnë zbatimin e këtyre marrëveshjeve apo marrëveshja të tjera në të ardhmen. Duhet një diplomaci e fuqishme dhe një dozë imponimi në mënyrë që të përafrohen gradualisht interesat vetanake të të dy palëve.

Rreziku i kthimit prapa

Suksesi nuk duhet të vonohet sepse ka rrezik për zhvleftësim të mëtutjeshëm. Në mungesë të rezultateve dhe duke pasur parasysh raportet e tensionuara në veri, dialogu mund të

shkëputet nga realiteti dhe negociatorët mund të humbin edhe atë pak përkrahje popullore që e kanë për të vazhduar tutje. Nëse kredibiliteti shuhet, atëherë do të jetë shumë më vështirë të arrihen kompromise në të ardhmen.

Në kundërshtim me pritjet dhe disi në formë paradoksale, dialogu deri më tani duket që ka dëmtuar krijimin e besimit. Është një mendim shumë i përhapur që bisedimet deri më tani vetëm sa e kanë rritur distancën në mes të komunitetit shqiptar dhe atij serb; i kanë ngritur tensionet dhe e kanë vështirësuar jetën e qytetarëve³⁰. Ruajtja e *status quo-së* në një kohë kur pritjet kanë qenë të larta ka rezultuar në një efekt të kundërt, duke e minimizuar pajtimin. Opinioni publik reflekton kundërshtimet në rritje rreth dialogut:

23 përqind e të gjithë të anketuarve e shohin dialogun si të dobishëm apo shumë të dobishëm për Kosovën (në krahasim me 29 përqind sa ishte në qershor 2011), përderisa 33.5 përqind besojnë se dialogu është i dëmshëm apo shumë i dëmshëm për Kosovën (në krahasim me 29 përqind në qershor 2011)³¹.

Ka pasur paralajmërime që hapësira për dialog mund të ngushtohet, veçanërisht nëse qetësia nuk është e qëndrueshme dhe nëse

„reagimet e publikut ndaj incidenteve dhe provokimeve në terren janë të pamatura. Arrestimet arbitrare, pasiviteti ndaj veprimeve jo-tolerante dhe retorika publike konflikt-ndjellëse në mënyrë të paevitueshme mund të sjellin më shumë tensione dhe dhunë“³².

Raportet e rregullta periodike mbi Kosovën në Këshillin e Sigurimit në Kombet e Bashkuara e vendosin përgjegjësinë për këtë kryesisht tek udhëheqësit politikë të të dyja palëve. Janë pikërisht këta liderë që BE-ja shpreson që do të arrijnë paqen me njëri tjetrin.

Situata e sigurisë është përballur me sfida të shumta në pranverën e vitit 2012 kur njoftimi për mbajtjen e zgjedhjeve

lokale të Serbisë në Kosovë rezultoi në disa arrestime. Kosova i ka ndaluar disa serbë të Kosovës që punojnë për institucionet paralele serbe dhe Serbia është kundërpërgjigjur me arrestime të shqiptarëve të Kosovës që po udhëtonin përmes Serbisë. Incidenti më shqetësues ka qenë kapja e dy policëve të Kosovës nga xhandarmëria serbe.

Dialogu = tradhti?

Në Ballkan është lloj argëtimi të përcjellësh se kush me kënd po bisedon nëpër tryeza apo privat. Supozimi që të flasësh me tjetrin nënkupton të zbulon deficitin kulturor për dialog. Kulturat ballkanase duket që e shohin dialogun si të barasvlershëm me tradhtinë. Korrupsioni shumë i përhapur edhe më shumë i ndihmon perceptimit se paria politike është e shtyrë nga përfitimet personale në kurriz të popullit që përfaqëson. Është shumë e rëndësishme që të ndryshohen këto perceptime dhe të sqarohet se çfarë mundet të e çfarë nuk mund të bëjë një dialog — që lidhet drejtpërdrejt me qeverisjen e mirë në përgjithësi dhe jo vetëm në raport me komunitetet etnike.

Nuk është e nevojshme që dialogu të kuptohet më shumë se sa një proces ku dëgjon palën tjetër dhe përfshihesh në diskutim interaktiv dhe konstruktiv. Si rregull bazë dhe siç është përmendur edhe më sipër, „dialogu“ ndodh në mes të kundërshtarëve aktualë apo atyre të mëhershëm. Dialogu kërkon njohjen e çështjeve të rëndësishë reciproke dhe nuk sugjeron njohjen e legjitimitetit të kërkesave apo pozicioneve konkurruese. Si rezultat, dialogu duhet të jetë ambicioz në dy aspekte, në përfshirjen e të gjitha palëve relevante por edhe në kërkimin e ideve kreative apo kompromiseve, gjithmonë duke i kuptuar kufizimet e veta.

Sado i fuqishëm që të jetë, dialogu nuk ka gjasë që të çoj deri në ripërcaktimin e kufijve. Projekti i pavarësisë dhe dialogu mbi modalitet rreth tij erdhën si nevojë pas ndarjes së Jugosllavisë dhe pamundësisë që Kosova të bashkohet me

Shqipërinë apo me Serbinë. Në vend të kësaj, bisedimet duhet të kontribuojnë drejt qëllimeve realiste si rrezimi i barrierave ekonomike dhe mendore por edhe zbatimi i masave mbrojtëse.

Pozicionimi i palëve të interesit

Në çdo konflikt etnik apo proces të paqes dinamika brenda grupit zakonisht është më e rëndësishme se sa ajo ndaj palës tjetër. Mediat populiste dhe opozita zakonisht bëjnë akuza për tradhti, duke e përdorur kështu dialogun për qëllime politike. Por, dinamikat e brendshme nuk janë thjesht heqje e vëmendjes nga dialogu por janë përbërës jetik për suksesin e procesit negociues. Gjithmonë ka kundërshtarë të vërtetë të cilët duhet të konsultohen sikurse ka edhe ekstremistë të ndryshëm të cilët i përdorin emocionet populiste pa marr parasysh rezultatin. Të dy kampet mund të jenë me të vërtetë të motivuara apo thjesht oportuniste. Prandaj, është e rëndësishme të vlerësohen dinamikat e brendshme në të dy kampet në mënyrë që të sigurohet rruga e mëtutjeshme. Kapitulli në vazhdim vlerëson interesat e shfaqura nga katër aktoret kryesorë, serbët e Kosovës, Prishtina, Beogradi dhe bashkësia ndërkombëtare.

Serbët e Kosovës

Temat e dialogut prekin serbët e Kosovës më shumë se çdo bashkësi tjetër në Serbi apo në Kosovë. Udhëtimi i lirë, telekomunikacioni, regjistri civil dhe liria e lëvizjes duhet pikë së pari të sjellin përfitime për serbët e Kosovës të cilët kalojnë kufirin më shumë se cilido grup tjetër.

Ekziston një mendim i përhapur në mesin e serbëve të Kosovës se ata do të humbasin më së shumti nga rezultatet e dialogut—ata besojnë që Beogradi ka hyrë në këto bisedime për shkak të interesave të veta kombëtare dhe jo për të mbrojtur interesat e serbëve në Kosovë. Shumë serbë e shohin dialogun si rezultat i presionit nga bashkësia ndërkombëtare dhe si fillim i njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

Dallimet në mes të serbëve që jetojnë në veri të lumit Ibër dhe atyre në jug janë rritur edhe më shumë në vitet e fundit.

Pikë lidhëse në mes të serbëve të veriut dhe atyre të jugut megjithatë është mospërfshirja e tyre në dialog. Brengat e tyre, si pasojë, janë përfaqësuar në mënyrë jo të mjaftueshme. Serbët në veri kanë reaguar përmes bllokimit të zbatimit të marrëveshjeve të dala nga dialogu ndërsa ata në jug janë zhgënjyer që zgjidhjet e ofruara i adresojnë vetëm disa nga frustrimet e tyre.

Serbët e veriut nuk janë përfshirë në ekipin e Serbisë kryesisht për shkak të qëndrimeve të ndryshme politike. Serbët e jugut nuk janë përfshirë në ekipin e Kosovës me justifikimin se dialogu është i natyrës teknike prandaj nuk është aplikuar kriteri etnik. Ndërkohe, marrëdhënia në mes të serbëve në jug të Kosovës dhe Beogradit është duke u dobësuar në mënyrë drastike. Një pjesë e konsiderueshme e elitës politike të serbëve të Kosovës nuk është as pjesë e institucioneve të Kosovës e as të Serbisë dhe si rezultat nuk mund të ndikoj në dialog.

Komuniteti serb i Kosovës është i ndarë thellësisht dhe nuk mund të flas me një zë—që i ka mundësuar Prishtinës dhe Beogradit që t'i injorojë ata. Përderisa Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar nuk kanë mundësi të veprojnë si ndërtues të urave të komunikimit, as Beogradi nuk shihet si palë e paanshme.

Raundet e ardhshme të dialogut duhet të marrin në konsideratë këtë komunitet dhe të sigurohen që ai të përfshihet³³. Kjo është vështirë e realizueshme për shkak se pjesëmarrja e serbëve të Kosovës me cilëndo palë negociuese do të sjell implikime animi në një proces thelbësisht kundërshtues.

Po të ishin pjesë e ekipit negociues të Prishtinës do të krijonte perceptimin e rreshtimit në anën e Kosovës dhe kundër Serbisë dhe anasjelltas. Serbët e Kosovës duhet në mënyrë të pavarur të angazhohen me autoritetet e Kosovës që të ushtrojnë ndikimin e tyre për t'i adresuar brengat që

kanë. Natyrisht, ata duhet të jenë të hapur edhe për tu angazhuar me Beogradin, duke i adresuar kështu shqetësimet dhe kërkesat e tyre përmes dy palëve negociuese. Një forum i përbashkët në të cilin serbët e Kosovës do të mund t'i artikulonin nevojat e tyre do të vështirësonte injorimin e prioriteteve të tyre.

Prishtina

Angazhimi në dialog me Serbinë ka qenë shumë i vështirë për Kosovën. Prishtina veçse ka bërë kompromis të dhimbshëm pas dy raundeve të negociatave në Vjenë, të ndërmjetësuara nga ish presidenti i Finlandës, Martti Ahtisaari. Vështirësitë po ashtu rëndoheshin edhe nga mungesa e një kërkim faljeje zyrtare nga Serbia për krimet e kryera gjatë viteve të nëntëdhjeta e sidomos atyre krimeve të luftës më 1998-1999. Situata është përkeqësuar edhe më shumë me kthimin e elitës politike nacionaliste në pushtet në Serbi në vitin 2012, ku disa nga prijësit e saj kanë pasur rol vendimtar dhe lidhje të afërta me regjimin e Millosheviqit.

Edhe kontaktet më të thjeshta që mund të bëhen me zyrtarë serbë në tryeza të organizuara nga OJQ-ja në disa raste shndërrohen në subjekt të akuzave të ndërsjella në mes të partive politike. Në një nga seancat e Kuvendit të Kosovës, Kryeministri Hashim Thaçi nuk e ka mohuar faktin se është takuar me zyrtarë të lartë serbë, por u ka bërë thirrje edhe udhëheqësve të partive të tjera që të pranojnë se ata kanë bërë të njëjtën gjë³⁴.

Hyrja në një raund të ri të dialogut është perceptuar në masë të madhe si pajtim për pranimin e kompromiseve të tjera të dhimbshme. Kjo frikë u përforcua për shkak të një procesi të mbyllur ndaj publikut, gjë që është kërkuar nga ndërmjetësuesi.

Përderisa Kosova emëroi një zyrtar të lartë për bisedimet, Zëvendëskryeministrja e Kosovës Edita Tahiri, si udhëheqëse të ekipit negociator, nuk e kishte peshën e partisë kryesore në vend. Ky fakt kishte ngritur shqetësimin se Kryeministri po e shihte dialogun si proces me mundësi që Kosova të humbas; prandaj, ai nuk preferoi që të sakrifikojë një lider nga rrethi i tij i ngushtë. Në të njëjtën kohë, emërimi i një zyrtari më të lartë do të mund të nënkuptonte dërgimin e një udhëheqësi shumë më të lartë se sa homologu i tij serb.

Ekipi është përballur me kritika të ashpra nga deputetët opozitarë. Partia kryesore opozitare në Kuvendin e Kosovës, LDK-ja, kishte lëshuar seancën parlamentare në shenjë pakënaqësie me kryesuesen e ekipit negociator. Kritika ka pasur edhe nga brenda PDK-së. Kryetari i Kuvendit të Kosovës kishte kërkuar nga Kryeministri që të riorganizojë ekipin negociator, meqenëse sipas tij ekipi nuk kishte kapacitete për të udhëhequr dialogun³⁵. Por kryeministri morri përgjegjësi të plotë për marrëveshjet.

Një nga burimet kryesore të kritikave gjatë procesit ka qenë marrëveshja për përfaqësimin rajonal të Kosovës, meqenëse i referohet rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Megjithëse kjo referencë është kryesisht simbolike dhe nuk e vë në dyshim shtetësinë e Kosovës, është interpretuar si e rrezikshme për shkak se mund të hapë çështjen e statusit nga dera e pasme³⁶.

Në Kuvendin e Kosovës, vazhdimi i bisedimeve është kushtëzuar me zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve. Partia në pushtet e ka interpretuar këtë thjeshtë si rekomandim por jo vendim obligues për Qeverinë³⁷.

Kryesuesja e ekipit negociator ishte përballur me shumë kritika dhe një numër analistësh kishin bërë thirrje për një platformë konsensuale para fillimit të bisedimeve më serioze politike. Pavarësisht stabilitetit të koalicionit të shumicës,

një spektër politik më i gjerë është padyshim i dëshirueshëm për të diskutuar çështje të rëndësishme jetike kombëtare. Shumica e thjeshtë në Kuvend i jep legjitimitet të kufizuar për koalicionin e tanishëm qeverisës që të filloj një proces të tillë të vështirë.

Presioni ndërkombëtar ka lobuar për të përfshirë LDK-në si „hisedar të një kompromisi të mundshëm“ mbi veriuin e Kosovës. Megjithatë, zyrtarët opozitarë nga LDK-ja dhe AAK-ja janë shprehur se nuk kanë interesim që të jenë pjesë e një projekti të tillë.

Sfida e Kosovës tanimë është e dyfishtë. Së pari, ka shumë pak interesim nga partitë opozitare që të jenë pjesë e bisedimeve. Këto parti shohin më shumë leverdi duke qëndruar jashtë tyre duke i kritikuar rezultatet e dialogut, gjë që mund të sjell atyre më shumë përfitime politike. Së dyti, „kundërshtimi i ashpër“ i Vetëvendosjes zvogëlon hapësirën manovruese të Qeverisë për të bërë kompromise që mund të konsiderohen si kalim përtej natyrës „teknike“ të dialogut.

Opozita ka deklaruar që Kosova ka humbur më shumë se sa që ka fituar. Siç ka thënë ish Ministri i Punëve të Jashtme,

Serbia tanimë ka filluar të përdor marrëveshjen për përfaqësimin rajonal për lobim kundër pavarësisë së Kosovës. Beogradi po e përdor praninë e Rezolutës 1244 në fusnotë për tu thënë shteteve të ndryshme që të mos ta njohin Kosovën. Përmes kësaj fusnote, shqiptarët në një mënyrë implicite i kanë pranuar bisedat për statusin³⁸.

Ky interpretim i marrëveshjes thekson vështirësitë e krijimit të përkrahjes së gjerë për dialogun dhe evitimin e perceptimeve të shumës zero në veçanti gjatë diskutimit të çështjeve me rëndësi kombëtare por edhe me shumë rëndësi simbolike.

Beogradi

Qeveria e kaluar e Serbisë ka qenë e gatshme të bëjë koncesione, por gjithmonë nën presion:

Nën udhëheqjen e DS [(Partisë Demokratike)] Serbia ka ndërmarrë disa hapa, vështirë të imagjinueshëm menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, por shpesh në momentin e fundit dhe nën presion të shtuar nga BE-ja dhe duke bërë vetëm minimumin e kërkuar³⁹.

Një qeveri e udhëhequr nga DS do ta kishte pasur përparësinë për tu bazuar në përvojën e dialogut të mëhershëm për të siguruar një orientim qeveritar pro BE-së. Në të njëjtën kohë, një qeveri e tillë do të ishte më e dobët se sa pasardhësja e saj dhe çdo kompromis që mund të arrihej me Prishtinën do të ishte qenë subjekt i kritikave të rënda nga SNS (Partia Progresive Serbe).

Bilanci i fuqisë ka lëvizur dukshëm në Serbi si rezultat i zgjedhjeve presidenciale të vitit 2012. Zgjedhja e Tomislav Nikoliqit për President të Serbisë shënoi një nga zhvillimet më të rëndësishme politike që nga viti 2000. Për herë të parë, një politikan që nuk ka qenë pjesë e koalicionit që e kishte rrëzuar Millosheviqin ka ardhur në pushtet. Krijimi i një koalicioni qeveritar të udhëhequr nga Partia Socialiste vetëm sa e kompletton këtë proces të ri politik.

Ne kurrë nuk e kemi dëgjuar Nikoliqin të distancohet nga politika kriminale e Serbisë karshi Kosovës. Njëjtë sikur Daçiq, edhe ai ka qenë zyrtarë i lartë politik i qeverisë së Serbisë që i ka zbatuar ato politika. Nikoliq ka qenë zëvendës Kryeministër gjatë viteve 1998 dhe 1999, në kohën kur janë kryer krimet më të mëdha shtetërore ndaj shqiptarëve.⁴⁰

Platforma elektorale e Nikoliqit nuk ka ndryshuar shumë nga ajo e Tadiqit dhe Kosova nuk ka qenë e përfshirë shumë në të. Duke shikuar nga kjo perspektivë, rezultati i

zgjedhjeve nuk do të thotë se do të ketë ndryshim të madh në politikën e Serbisë ndaj Kosovës.

Megjithatë, Kosova në aspektin taktik ende mbetet e rëndësishme për politikën e brendshme të Serbisë. Autoritetet arrestuan dhe burgosën një numër shqiptarësh të Kosovës të cilët po udhëtonin përmes Serbisë. Këto arrestime kanë ndodhur ekskluzivisht gjatë fushatës zgjedhore në Serbi—një indikacion që ishin arbitrare dhe të dizajnuara për konsum të brendshëm. Arrestimi spektakular i dy policëve kufitar e ka dobësuar edhe më shumë besimin e Kosovës në sinqeritetin e Serbisë në dialog.

Deklaratat e Nikoliqit para dhe pas zgjedhjes së tij tregojnë për mungesë të ndjeshmërisë diplomatike dhe dobësinë e partisë së tij në aspekt të përvojës. Si rezultat, çdo dialog i qeverisë së re me Kosovën do të marrë kohë të konsiderueshme që të formësohet dhe do të shoqërohet me vështirësi. Në anën tjetër, ajo çfarë i mungon në përvojë dhe stil, e kompenson duke qenë e drejtpërdrejtë dhe politikisht të fortë.

Shtytjet e Serbisë për pjesëmarrje kanë qenë në masë të madhe jashtë substancës së dialogut. *Status quo-ja* në Kosovë kryesisht i përshtatet Serbisë. Në anën tjetër, Kosova është e interesuar që të ndërrojë *status quo-në* dhe të arrijë marrëveshje që i ndihmojnë konsolidimit të shtetësisë. Mirëpo Kosova ka qenë hezituese që të pranojë bisedime me Serbinë duke u frikësuar që bilanci mund të ndryshojë dhe të shkojë në favor të Serbisë.

Edhe pse Presidenti Nikoliq i ka reformuar porositë e tij së fundmi për tu dukur më pro-evropian dhe më pro-perëndimor, ai dikur kishte deklaruar se „Serbia do të ishte më mirë po të ishte provincë e Rusisë se sa t’i bashkohej Bashkimit Evropian“⁴¹. Ngjashëm, ish Presidenti i Serbisë kishte deklaruar që „katër shtyllat“ e politikës së jashtme të Serbisë janë BE-ja, Rusia, SHBA-të dhe Kina⁴². Në këtë

mënyrë, udhëheqësit e Serbisë vazhdimisht tentojnë të fryjë fuqinë e vet karshi bashkësisë ndërkombëtare, duke i theksuar lidhjet e Serbisë me lindjen dhe me perëndimin.

Qeveria e re po mundohet që të sigurojë një konsensus të gjerë për vazhdimin e dialogut dhe që të vendos në letër udhërrëfyesin për qasjen e ardhshme të Serbisë në këtë proces⁴³. Pas bisedimeve të para të nivelit të lartë të udhëhequra nga Presidenti Nikoliq, tani bisedimet tani me gjasë do të udhëhiqen nga Kryeministri Daçiq.

Përparësia kryesore e një koalicioni serb të udhëhequr nga SNS dhe SPS (Partia Socialiste) qëndron në faktin se ata virtualisht nuk përballen më asnjë kundërshtim ndaj dialogut. Borislav Stefanoviç, një zyrtar i Partisë Demokratike dhe ish udhëheqësi i ekipit negociues të Serbisë në dialogun me Kosovën, ka deklaruar që qeveria e re ka tentuar të ndalojë, komprometoj dhe shkatërrojë procesin e dialogut. Mirëpo, ai ka përmendur se DS-ja do të përkrah çdo përpjekje të guximshme dhe zgjidhje jo-pulllore që nuk shpie drejtë njohjes së Kosovës⁴⁴.

Nikoliqi po ashtu ka sqaruar disa nga rezultatet e dyshimta të një të marrëveshjeve. Menjëherë pas marrjes së detyrës, ai akuzoi qeverinë e kaluar për fshehje të faktit që vetëm emri „Kosovo“ me një yll, por pa fusnotën shtesë, do të paraqitet para ‘shqiptarëve’ nëpër takime rajonale. Sipas tij, po ashtu edhe deklarimi i qeverisë së kaluar që serbët në veri të Kosovës nuk duhet të marrin tabelat e regjistrimit të Kosovës ka qenë mashtrim, ngase kushti për këtë me të vërtetë ka qenë që ata duhet të regjistroheshin si qytetarë të Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare

Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës rendit prioritetet parandaluese për vitin 2012, duke përfshirë edhe 30 rreziqet kundër sigurisë kombëtare

të SHBA-ve. Asnjë nga këto prioritete nuk ndërlidhen me Ballkanin. Mementalisht, dhe pavarësisht kësaj, konsolidimi i shtetësisë së Kosovës në tërë territorin e saj është prioritet i SHBA-ve. Megjithatë, SHBA-të janë duke u munduar që të bartin shumicën e përgjegjësive për Ballkanin në Bashkimin Evropian, mirëpo duke mos bërë kompromise me objektivat e saj⁴⁵. Një pjesë e madhe e këtij roli është marrë nga Gjermania dhe disa nga institucionet e BE-së. Për këtë arsye, është me rëndësi që të vlerësohet BE-ja si akteri kryesor në bashkësinë ndërkombëtare.

BE-ja e ka ndërmarr rolin kryesor në dialog dhe ky është tipari kryesor i bisedimeve. BE-ja ka mundësi që të jetë një ndërmjetës efektiv ngase edhe Kosova edhe Serbia aspirojnë integrimin në BE. Sidoqoftë, angazhimi i BE-së në Kosovë që nga vitit 2008 ka qenë shumë kundërthënës.

EULEX-i ka qenë shumë i kritikuar për arsye të ndryshme dhe BE-ja është munduar të ecë në linjë edhe me kërkesat e shteteve brenda BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën e në anën tjetër të angazhojë me Kosovën në mënyrë konstruktive. Përparësia kryesore e BE-së në procesin e ndërmjetësimit ka qenë aftësia për të ofruar motive edhe jashtë përmbajtjes së negociatave dhe që lidhen kryesisht me përafrimin me BE-në.

Udhëheqësit serbë në veri e akuzojnë EULEX-in që është vënë në anë të Prishtinës që nga fillimi⁴⁶. Udhëheqësi i Qarkut të Mitrovicës i emëruar nga Qeveria e Serbisë, Radenko Nedeljkoviç, ka folur kundër mandatit të EULEX-it. Në veçanti, ai ka kritikuar EULEX-in për përgatitjen e krijimit të doganës në Jarinjë dhe Bërnjak dhe pikëkalimet kufitare në veri të Kosovës, sipas tij, duke zbatuar kështu vendimet e njëanshme të Prishtinës.

Beogradi duke bërë shumë pak dhe shumë vonë i ofrohet shumë kufirit të tolerancës nga BE-ja, pasi që BE-ja dhe shtetet tjera anëtare besojnë që Beogradi lëviz vetëm kur është i detyruar⁴⁷.

Situata aktuale financiare në BE disi ka zbehur kredibilitetin e anëtarësimit në BE si një shtytje për reformë në Ballkanin Perëndimor. Në Serbi, Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë, shumë pak besojnë që anëtarësimi në BE do të materializohet në të ardhmen e afërt. Ata po ashtu besojnë që kriteret e anëtarësimit po shkojnë duke u vështirësuar. Nën këto kushte, anëtarësia në NATO ka fituar një rëndësi të shtuar, meqenëse është më e besueshme dhe më afatshkurtër për tu realizuar⁴⁸.

Si lehtësuese e dialogut por edhe autoriteti përfundimtar për të vlerësuar rezultatet e dialogut, BE-ja ka përçarur mesazhet të përziera. Raportet e progresit, konkluzionet e këshillit dhe dokumentet e tjera të BE-së kanë vendosur pika të qarta të udhërrëfimit për të dy palët, përderisa Zyra e BE-së për dialogun teknik deri më tani ka heshtur. Mesazhet kundërthënëse shpesh e japin perceptimin që BE-ja shpërblen performancën agresive.

Qartësimi është i nevojshëm jo vetëm për shkak që disa anëtare të BE-së mund të kundërshtojnë integrimin e Serbisë, mirëpo edhe për faktin që BE-ja si organizatë nuk ka kapacitet për të adresuar kundërshtime të tilla të hapura, së paku prej momentit kur njëra palë veç arrin të bëhet anëtare. Dobësia e BE-së i ka inkurajuar disa akterë të sfidojnë politikën e saj të jashtme.

Trupat e NATO-s dhe policia e BE-së kanë vepruar jashtë mandatit të OKB-së për ruajtje të paqes përmes imponimit të doganave të Kosovës në veri pa ndonjë marrëveshje paraprake politike. Ata janë aty për të ruajtur paqen përderisa të tjerët duhet të mundohen t'i zgjidhin dallimet politike⁴⁹.

Meqë përparësia e BE-së si ndërmjetësuese përfundon në momentin e anëtarësimit, ajo duhet të sigurohet që procesi i negociimit të përfundojë para anëtarësimit të cilësdo palë, në këtë rast më shumë ka të ngjarë të Serbisë.

Ky rol i fuqishëm mund të luhet nëse BE-ja perceptohet si akter i drejtë. Shumica e akterëve shqiptarë të Kosovës e shohin BE-në si disi të anshme. Ata e shohin ofrimin e statusit të kandidatit Serbisë përderisa Kosova ende nuk ka qasje në të gjithë territorin e saj. Përdorimi i kushtëzimit nga BE-ja është burimi kryesor për motivim për bashkëpunim, gjë që do të vlerësohet më në detaje në kapitullin e ardhshëm.

Shtytjet për bashkëpunim

Ka shumë pengesa potenciale për vazhdimin e një dialogu të suksesshëm. Dialogu nuk ka mundur të gjenerojë dinamika pozitive në të cilat palët do të perceptonin kompromiset e arritura si me përfitime për të gjithë. Ekzistojnë disa sfida kryesore të cilat do të diskutohen më poshtë, përfshirë: (a) atë që afërsia ka qenë më e vogël sesa është dukur, (b) zbatimi do të jetë i vështirë, dhe (c) lëvizja drejt dialogut pozitiv shihet si një përpjekje e dëshpëruar pas dështimit të bisedimeve teknike, dhe nuk inkurajohet nga sukcesi i tyre. Është thelbësore që BE-ja të sigurojë një strukturë të shtytjes që do të përshkruhet në sasi të mjaftueshme dhe e cila do të shpie sjellje të moderuar nga të gjitha palët.

Kushtëzimi i BE-së

Motivi kryesor për pjesëmarrjen e Serbisë në dialog ka qenë oferta për përafrim raportesh me BE-në, si shpërblim. Serbia e ka parë që ka pak përfitim nga dialogu duke pasur parasysh që bisedimet nuk kanë adresuar statusin e Kosovës. Prandaj, çdo ndryshim i *status quo-së* ka qenë tërheqëse vetëm për shpërblimet që BE-ja mund të ofrojë.

Kërkesat kryesore për kushtëzim të suksesshëm kryesisht janë zotimi i shtetit (i elitave politike por edhe i publikut të përgjithshëm) për integrim në BE dhe kërkesat e formuluarat qartë dhe në mënyrë të prekshme nga BE-ja. Nëse kushtet zgjerohen përtej kërkesave bazë të paraqitura në *acquis communautaire* apo në Kriteret e Kopenhagës, ato duhet të mbesin të arsyeshme. Duhet të ekzistojë balancë në mes të asaj nga e cila duhet të hiqet dorë dhe ajo që do të fitohet si shpërblim. Kushtëzimi nuk mund të ketë sukses nëse një vendi i kërkohet që të zotohet për ndryshime radikale nëse shpërblimi shihet si diç e largët.

Qiproja është shembulli më i mirë se si shtytjet e pabilancuara mund të përfundojnë në dështime. BE-ja i kishte ofruar anëtarësi të plotë Qipros, duke krijuar kështu një motiv të fortë për turqit e Qipros që të përkrahin Planin e Annanit për të unifikuar ishullin, meqenëse do të sjellte përfitime menjëherë përmes integritit në BE. Në anën tjetër, grekët e Qipros do të hynin në BE pa marrë parasysh rezultatin e referendimit mbi Planin e Annanit. Si rezultat, në mesin e grekëve të Qipro-s integrimi në BE nuk ka qenë kurrfarë motivi për të votuar në favor të unifikimit. Mësimi kryesor i mësuar nga Qiproja nuk është rreziku i importimit të një rreziku brenda BE-së, por është rreziku i ofrimit të motivit vetëm për njëerën palë në një proces negociues, pa qenë të gatshëm për të ndaluar anëtarësimin në BE.

Rreziku i dytë nga kushtëzimi vie si rezultat i krijimit të një liste të gjatë të kushteve. Nëse një shtet (apo njëri nga shtetet me të drejtë të vetos) nuk ka vullnet që të përmbush një kusht të caktuar, atëherë BE-ja duhet të tërhiqet nga shpërblimet e premtuara. Në të njëjtën kohë, këto shpërblime duhet të sjellin përfitime edhe për shtetin i cili po kushtëzohet. Prandaj, BE-ja përballet me zgjedhjen e vazhdimit të kushteve apo ndalimit të anëtarësimit ose të zbutjes së këtyre kushteve. Ky skenar i fundit ka ndodhur në Bosnjë në lidhje me reformën e policisë në mes të viteve 2004 dhe 2008. Ky skenar krijon një rrezik moral ku palët mund të inkurajohen kundër përmbushjes së kushteve të vëna përpara. Kjo ndodhë pasi që presin të arrijnë të dy qëllimet, lidhje më të ngushta me BE-në dhe politika apo çështje të cilat atyre u është kërkuar që t'i ndryshojnë bazuar në kushtëzim.

Në veçanti, ky fakt del të jetë shumë i vërtetë në dialogun në mes të Serbisë dhe Kosovës. Për shembull, nëse Serbisë i kërkohet që të njohë pavarësinë e Kosovës para anëtarësimit në BE dhe ky lajm i komunikohet shumë herët, atëherë ka rrezik që Serbia nuk do të jetë e gatshme që ta paguajë këtë

„çmim“. Përballë zgjedhjes për të shtyrë pafundësisht anëtarësimin e Serbisë në BE dhe rreziqeve që kjo mund të sjell, zërat brenda BE-së që bëjnë thirrje për të zbutur këtë kusht mund të rriten. Prandaj, kur të vendoset se çfarë shkalle e rezultatit të dialogut është i nevojshëm për nivelin e anëtarësimit në BE, ky rrezik duhet të merret parasysh.

Mjeti kryesor i BE-së ka qenë kushtëzimi në mënyra që shkojnë përtej procesit „tradicional“ të integritit. BE-ja ka siguruar ndryshime duke i lidhur ato drejtpërsëdrejti me anëtarësimin. Kjo formë ka qenë e suksesshme sa i përket bashkëpunimit të rajonit me Tribunalin Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi, mirëpo përpjekjet për ndërlidhjen e shtet-ndërtimit me anëtarësimin në BE në shtetin e Bosnjës kanë sjellë sukses modest⁵⁰.

Problemi kryesor me këtë mënyrë të qasjes qëndron në motivimin disproporcional që u bëhet palëve. Në rastin në fjalë, Serbia qartazi tanimë ka perspektivë të anëtarësimit dhe prandaj dhënia e statusit të kandidatit ka shënuar një „karotë“ të prekshme për Serbinë. Mungesa e unitetit sa i përket statusit të Kosovës brenda BE-së e parandalon atë që t'i ofrojë Kosovës një rrugë të tillë të qartë.

Për më shumë se një vit, Gjermania e ka marrë rolin kryesor të kushtëzuesit perëndimor ndaj Serbisë. Një skemë karotash në rrugën e Serbisë drejt BE-së është prezantuar. Në fillim mesazhet ishin të mjegullta dhe komunikoheshin përmes vizitave dypalëshe por gradualisht ato u bënë më të fuqishme, më të qarta dhe u shndërruan në deklarime zyrtare. Mesazhi i parë zyrtar ishte dhënë nga Presidenti i Këshillit të Evropës Herman Van Rompuy. Në Beograd, Rompuy kishte thënë së përmirësimi i raporteve me Kosovën ishte një kriter për Serbinë në mënyrë që t'i njihet statusi i kandidatit për anëtar të BE-së⁵¹. Kushtet e vëna Serbisë, që në fillim përmendeshin vetëm nga disa shtete, përfunduan duke qenë pjesë e raportit të progresit, duke u

shndërruar kështu në mënyrë efektive në kushte zyrtare të Bashkimit Evropian.

Normalizimi

Koncepti i normalizimit ka qenë i dobishëm si emërtim për raporte të mira fqinjësore dhe bashkëpunim bilateral që nuk përfshin njohjen. Ky do të ishte një vazhdim logjik i dialogut të gjertanishëm, duke i ndarë çështjet substanciale (të quajtura “teknike”) nga ato simbolike (të quajtura “politike”).

Kosova dhe BE-ja janë ngushtë të lidhura me njëra-tjetrën në lidhje me Serbinë. BE-ja e ka përdorur shumë mënyrën e kushtëzimit në dialogun Prishtinë-Beograd dhe tani ekziston një mendim shumë i përhapur brenda BE-së që progresi i Serbisë drejt BE-së duhet të kushtëzohet me “normalizimin” gradual të raporteve të saj me Kosovën. Vendimet për zgjerim kërkojnë pajtimin e të gjitha 27 shteteve anëtare të BE-së, prandaj kushtëzimi mund të përdoret nga secili anëtar individualisht. Ka qenë

Vizita e ministrit të jashtëm të Britanisë së Madhe që e ka bindur Tadiqin që ta braktisë iniciativën e planifikuar për të rihapur bisedimet për statusin në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe ka qenë Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel e cila në gusht të vitit 2011 shumë qartë e kishte lidhur statusin e kandidatit për Serbinë me përmirësimin e raporteve të saj me Prishtinën⁵².

Njohja graduale por substanciale pa u bërë njohja simbolike apo formale do të mundësonte një proces gradual por nuk do të rrezikonte integrimin e Serbisë. Pika kryesore kthyes mbetet identifikimi i momentit se kur Serbia do të heq dorë nga kërkesat territoriale ndaj Kosovës. Përderisa procesi i “normalizimit” më së paku nënkupton një proces të pakthyesëm dhe progres nga *status quo-ja*, disa anëtare të

BE-së kanë kërkuar që pretendimet territoriale të hidhen poshtë⁵³.

Deri në vitin 1999, kushtetuta e Irlandës përmbante në vete pretendimin mbi të gjithë territoret e ishullit irlandez, siç theksohet në nenin 2, “territori kombëtar përbëhet nga i gjithë ishulli i Irlandës, ishujt e saj dhe ujërat territorial”. Ky nen është amendamentuar vetëm pas mbajtjes së referendumit pas arritjes së marrëveshjes së Premtes së Mirë. Në të njëjtën kohë, Irlanda nuk ka vepruar në mënyrë aktive që të dëmtojë sovranitetin e Britanisë së Madhe mbi Irlandën e Veriut. Si rezultat, pretendimi simbolik ka bashkekzistuar me një realitet pragmatik. Prandaj, në këtë kuptim, Kushtetuta e Serbisë mund të vazhdojë të ketë pretendim simbolik mbi Kosovën,⁵⁴ për aq sa qeveria dhe institucionet e saj nuk veprojnë ndaj këtij pretendimi.

Një çështje e rëndësishme që duhet të merret në konsideratë është koha e realizimit të zgjerimit të BE-së. Deri më tani, BE-ja ka insistuar në qasjen “çdo shtetit duke u bazuar në meritat e veta”, për sa i përket procesit të zgjerimit për Ballkanin Perëndimor. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë, gjasa të konsiderueshme ka që Serbia të jetë “gati” për tu anëtarësuar në BE, para Kosovës. Sidoqoftë, në mënyrë që të evitohet skenari në të cilin Serbia mund të bllokojë anëtarësimin e Kosovës, ngjashëm si rasti i bllokimit të Maqedonisë nga Greqia, është thelbësore që të bëhet lidhja e së ardhmes evropiane të të dy palëve për tu siguruar që normalizimi i plotë dhe njohja eventuale të jenë rezultate të prekshme dhe të pakthyeshme.

Mundësia e Serbisë që të bllokojë Kosovën duhet të ndërpritet dhe Serbia duhet të zotohet të braktisë politikën anti-Kosovë. Lehne argumenton që çdo politikë e tillë kundër Kosovës është kundër interesit të BE-së. Ai deklaron që: “Nëse Serbia do të bëhet shtet i ri anëtar i BE-së dhe do të bllokonte progresin e mëtutjeshëm të Kosovës drejt BE-së atëherë do të ishte kundër-produktive edhe për vet politikat

e BE-së karshi rajonit”, një klub ky që Serbia aspirojnë t’i bashkëngjitet⁵⁵.

Kosova dhe Serbia ose duhet të anëtarësohen së bashku në të njëjtën kohë ose Serbia do të duhej të pranojë obligim ligjor për të mos bllokuar integrimin evropian të Kosovës. Qasja e mësipërme do të nënkuptonte përparësinë që asnjë kufi i jashtëm i BE-së nuk do të krijohej në mes të Kosovës e Serbisë (lëre më kufiri Schengen). Kjo qasje e ka një mangësi sepse do të vononte integrimin e Serbisë dhe do të mund të dëmtonte në mënyrë shumë serioze përkrahjen ndaj BE-së në Serbi. Kjo do të mund të krijonte situatë të ngjashme apo edhe më të keqe se sa me rastin e përkrahjes ndaj BE-së në Kroaci që gati se po shuhej fare në mes viteve 2003 dhe 2010.

Kushti vetëm për “normalizim” është shqetësues për Kosovën. Zyrtarët serbë e mbajnë qëndrimin që ata do të jenë në gjendje që ta marrin me vete në Bashkim Evropian edhe problemin e Kosovës, siç ka qenë rasti me Qipron. Siç ka thënë ish-Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Qeverisë serbe për Kosovën,

Çdo presion mbi Serbinë për të ndryshuar pozicionin e saj karshi Kosovës është i prirë për të dështuar, prandaj në fund do të vie deri te çështja se si të anëtarësohet Serbia në BE me problemin e Kosovës ende të pazgjidhur. Përgjigja ime është që do të veprohet njësoj si me Qipron apo me Republikën e Irlandës⁵⁶.

E vetmja garanci që Kosova ka janë premtimet dypalëshe që shtetet perëndimore i janë zotuar Kosovës se do të bëjnë më të mirën që të bindin Serbinë që eventualisht ta njohë Kosovën. Në aspektin afatshkurtër, shqetësimi specifik i Kosovës është që Serbia do të marrë datën për negociim vitin e ardhshëm por pa bërë atë që do të ishte e mjaftueshme që ambiciet e Serbisë karshi Kosovës të jenë të pakthyeshme.

Dy dyert e Serbisë

Serbia ka qenë shumë afër marrjes së statusit të kandidatit në fund të vitit 2011. Siç ka deklaruar edhe Ognjen Pribiçević, ish ambasadori serb në Berlin, ka ekzistuar perceptimi në Serbi që nuk ka qenë kërkesë që “negociatat po ndodhin apo të përfundohen, thjesht të vazhdojnë”⁵⁷. Marrëveshja për Stabilizim Asociim më në fund i është dhënë Serbisë në mars, edhe pse ka bërë fare pak përveç vazhdimit të dialogut.

Vendimi i BE-së për t’i dhënë Serbisë statusin e kandidatit i ka inkurajuar ithtarët e BE-së në Serbi. Një matje e opinionit në mars theksoi që 54% e serbëve ishin në favor të BE-së. Përderisa ky vendim e ka ndikuar opinionin publik, sipas analistit politik Branko Radun, trendi i përgjithshëm në Serbi, është ai i “rënies së ndjenjës pozitive ndaj BE-së”⁵⁸.

Perceptimi i lehtësimit së kriterëve për integrimin e Serbisë i ka ngritur shqetësime në Prishtinë se kriteri matës për Serbinë është zvogëluar. Data për dhënien e anëtarësimit ofron qasje në fondet strukturale, që është edhe caku i Serbisë. Sipas këtij skenari, Serbia mund të ngadalësojë rrugën e qasjes së re me Kosovën dhe kështu do të ishte edhe më rehat me *status quo-në* meqenëse koha do të ishte në anën e saj. Në këtë pikë, do të ishte shumë e vështirë që të krijohen mekanizma për t’ia ndaluar Serbisë fondet e BE-së për shkak të mungesës së progresit të prekshëm me Kosovën në ndonjë faze të mëvonshme. Prishtinës i vjen keq për këtë situatë për shkak se ndjen se po krijohet një situatë asimetrike e cila e vë progresin e Kosovës në një rrugë më të ngadalshme për Bruksel.

BE-ja ka përparuar në trajtimin e një qasjeje të re të Serbisë ndaj Kosovës si kusht formal për anëtarësimin e Serbisë. Kritikët e kësaj politike argumentojnë mbi distancën e Serbisë ndaj BE-së dhe mundësinë që ky shtet ta heq dorë nga ideja e integritit dhe të ndërrojë kursin e saj duke u

larguar BE-së. Kritikët edhe më të ashpër e kanë quajtur këtë si kërkesë që Serbia ta dorëzojë veriun tani nëse ka dëshirë që ndonjëherë të marr kandidaturën⁵⁹.

Integrimi në BE ka qenë gati një zotim strategjik i Serbisë, ngase së paku një çështje dytësore (Kosova) nuk i nënshtrohet këtij qëllimi të madh. Serbia ka tentuar që të maksimizojë përpjekjet për integrim evropian por gjithmonë duke i ruajtur pretendimet e saj mbi Kosovën. Ivica Daçiq, ish-zëvendëskryeministri dhe ministri i brendshëm i Serbisë i cili tani është Kryeministër i vendit, është në favor të integritit evropian por vetëm përderisa Serbia mund t'i ruajë interesat e veta nacionale. Sipas tij, Bashkimi Evropian qartazi po i shkel interesat nacionale të Serbisë në lidhje me Kosovën.

Deri më tani, nuk ka pasur shenjë të qartë nga Serbia që ajo do të bënte kompromis duke hequr dorë nga Kosova në mënyrë që të anëtarësohet në BE. Kjo e bën BE-në që të ecë nëpër tehtë të thikës: nëse insiston që Serbia të heq dorë shumë herët nga Kosova në shkëmbim të anëtarësimit të plotë, ka rrezik që Serbia mund (përkohësisht) të braktisë idenë e integritit evropian. Mirëpo, në anën tjetër, pa u siguruar së paku jo-formalisht që një marrëveshje gjithëpërfshirëse do të arrihet si pjesë e procesit të anëtarësimit, ekziston rreziku që qasja aktuale e BE-së ndaj dialogut mund të dështojë.

Në kohën kur porosinë diplomatike po fuqizoheshin dhe “normalizimi” po kërkohej nga Serbia, zëvendëskryeministri dhe ministri i brendshëm i asaj kohe kishte deklaruar që duhet thënë haptas dhe qartë që Serbia nuk do të fitojë statusin e kandidatit pa e njohur Kosovën⁶⁰. Nëse njohja e Kosovës do të ishte një kusht me të vërtetë, Daçiq kishte thënë që atëherë se serbët do ta dinë se çfarë zgjedhje duhet bërë. Para zgjedhjes si President i shtetit, kryetari i Partisë Progresive Serbe (SNS), Tomislav Nikoliq, kishte thënë që Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën, edhe nëse kjo do t'i

kushton me mos-anëtarësim në BE⁶¹. Nikoliq po ashtu kishte thënë që ai e përkrah anëtarësimin e ardhshëm të Serbisë në BE, por kishte nënvizuar që shteti i ka “Dy dyer”, një që shpie drejt lindjes dhe tjetra drejt perëndimit⁶².

Frika në Serbi është se shteti mund të lodhet nga reformat e vështira që duhen bërë para fitimit të vetë shpërblimit. Në momentin që qytetarët serbë do ta kuptojnë që në aspektin afatshkurtër, Serbia nuk do të fitojë asgjë nga dialogu, përkrahja publike pro-BE do të shkojë duke rënë.⁶³ Nëse Serbia e merr datën për bisedat rreth anëtarësimit duke bërë shumë pak për të sjellë ndryshime substanciale në dinamikën karshi Kosovës, motivimi për dialogun e mëtutjeshëm dhe zbatimin e marrëveshjeve mund gjithashtu të dobësohet.

Zbatimi i marrëveshjeve të dialogut ka mbetur shumë mbrapa dhe është shndërruar në çështje kontestuese. Palët nuk i besojnë vullnetit të mirë të njëri-tjetrit dhe disa nga marrëveshjet kanë mungesë të qartësisë dhe transparencës që ka rezultuar në interpretime të ndryshme.

Zbatimi i secilës pikë individualisht është diskutuar më sipër në këtë punim. Është e qartë që Serbia ka dyshime në lidhje me zbatimin e pikave në veri, dhe kjo shpie drejt dy rreziqeve potenciale në të ardhmen, zbatimin problematik të çështjes së regjistrimit të tabelave dhe marrëveshjes së IBM-së në veri. Mos-zbatimi i tyre do të paralajmërojë ndrysh të politikës për veriu dhe mund të sinjalizojë një periudhë problematike.

Lidershipi i ri në Beograd është këshilluar nga udhëheqësit e mëparshëm që zbatimin e marrëveshjeve është thelbësor. Nikoliq haptazi ka deklaruar që ai nuk do të jetë i obliguar që t'i zbatojë marrëveshjet me Kosovën pasi që të vie në pushtet. Si përgjigje, ish ministri i Punëve të Jashtme Vuk Jeremiq i kishte dërguar porosi Presidentit të ri që Beogradi duhet t'i respektojë marrëveshjet e arritura me Kosovën. Ai

kishte shtuar që mos-zbatimi i këtyre marrëveshjeve do të ishte një sinjal i keq që Serbia mund t'i dërgonte bashkësisë ndërkombëtare dhe kjo po ashtu do të kishte pasoja të mëdha në proceset e ardhshme dialoguese edhe për vetë imazhin e Serbisë⁶⁴.

Tani kur Daçiçi edhe Nikoliqi janë në krye të pushtetit në Serbi, kushtëzime edhe më të vështira janë paralajmëruar, megjithëse ato ende nuk janë zyrtarizuar. Fatmirësisht, shenjat e para lënë të kuptohet që asnjëri nga këta dy udhëheqës nuk do të braktis BE-në siç kishin kërcënuar në të kaluarën. Në këtë kuptim, rreziku i braktisjes së idesë së BE-së tani duket që është dukshëm më i vogël.

Drejt dialogut politik

Reagimet për dialogun janë nga më të ndryshmet. Disa i theksojnë përfitimet e vogla për qytetarët përderisa të tjerët e vënë theksin në vështirësitë e zbatimit në veri. Duke e pasur këtë parasysh, përmirësimi i raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit do të mund të kishte një efekt më të madh, duke mundësuar më shumë bashkëpunim në mes të dy shoqërive në të gjitha nivelet.

Dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit ende është në fazën e armiqësisë dhe akoma duhet të evoluojë deri në një nivel që të mund të rezultojë në sukses. Në një ambient ku ka ndodhur shumë pak dialog konstruktiv, është shumë befases fakti se sa shumë formate dhe propozime për dialog janë sugjeruar. Është me rëndësi që të gjitha formatet të mbështeten në formë të tillë që të përmbushin njëra-tjetrën.

Në kohën kur e konfirmon që statusi dhe integriteti territorial i Kosovës nuk janë të hapura për diskutim, Prishtina duhet t'i sinjalizojë serbët e Kosovës në veri e po ashtu edhe Beogradin për gatishmërinë e saj për tu angazhuar në dialog dhe për t'i përmirësuar aranzhimet për vet-qeverisje. Po ashtu duhet të japë indikacione edhe për gatishmërinë për të adresuar shqetësimet shtesë të Kishës Ortodokse Serbe dhe çështjet që lidhen me pretendimet pronësore⁶⁵.

Prandaj, dialogu duhet të avancohet në mënyrë që të adresohen të gjitha çështjet diskutuese. Në të njëjtën kohë, duhet të ruhet qasja konstruktive që ka zvogëluar peshën simbolike të temave. Për momentin është e sigurt që tre variante janë në tavolinë:

- Vazhdimi i dialogut në mes të ekipeve të ekspertëve në nivel teknik, qëndrimi zyrtar i Prishtinës;
- Vazhdimi i dialogut me një nivel politik më të lartë, ose

- Kombinim në mes të dy opsioneve, me mundësinë e përfshirjes edhe të veriut⁶⁶.

Para se dialogu teknik të ndërpritej për shkak të zgjedhjeve në Serbi, së paku edhe tri tema të tjera ishin në plan për tu diskutuar: energjia elektrike, telekomunikimi dhe trafiku ajror. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të sillte përfitime të konsiderueshme ekonomike për Kosovën dhe për Serbinë. Energjia elektrike dhe telekomunikimi ishin paralajmëruar si temat e para pas zgjedhjeve në Serbi, por po ashtu edhe si parapërgatitje për dialog politik.

Më shumë progres ‘teknik’

Diskutimi i çështjeve teknike në fillim kanë mundësuar sjelljen e rezultateve të prekshme, mirëpo disa çështje të ndjeshme “politike” janë imponuar në agjendë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me veriun. Emërtimi i bisedimeve si “teknike” mund të konsiderohet më shumë si strategji negociimi se sa si përshkrim i përmbajtjes. Nga vetë natyra e tyre, ato kanë qenë politike, siç ka deklaruar Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani⁶⁷. Robert Cooper ka deklaruar që në një mjedis kaq shumë të politizuar në raportet Kosovë-Serbi, gjithçka është politike⁶⁸.

Ekziston një besim që po rritet dita-ditës në mesin e qarqeve diplomatike që është e padobishme që të zgjidhen çështjet teknike dhe se Kosova dhe Serbia duhet të fillojnë të diskutojnë kontestet kryesore. Siç është përmendur më parë, konflikti i ngrirë në veri të Kosovës ka eskaluar disa herë gjatë viteve të fundit, duke e rrezikuar jo vetëm dialogun, por duke vënë në theks që çështjet më kundërthënëse në mes të dy shteteve janë ende të pazgjidhura. Për më shumë, në Kosovë po rritet frustrimi mbi mungesën e qasjes në organizata të ndryshme ndërkombëtare edhe pas kaluan katër vite nga shpallja e pavarësisë. Prandaj, edhe nuk ka dobi që të vazhdohet një dialog i mirëfilltë në mes të

Prishtinës dhe Beogradit përderisa do të injorohen këto çështje me rëndësi.

Çështje të tjera teknike duhet të ngritën dhe të zgjidhen paralelisht me dialogun politik. Nuk ka arsye që mos të hapen edhe tema të tjera të diskutimit—pas telekomunikimit, energjisë elektrike dhe trafikut ajror—tema si shkëmbimi i shërbimeve postare, lidhjet infrastrukturore, trashëgimia kulturore dhe shkëmbimet, hekurudhat si dhe pjesëmarrja në aktivitete sportive.

Është e qartë që dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradi që nga fillimi është dizajnuar që të realizohet në faza të ndryshme, nga “çështjet e vogla, teknike” deri te ato me të vështira dhe politike. Në Kosovë është e qartë që problemi kryesor politik është veriu. Prandaj, ekziston pritja që ky dialog i ri do të jetë për veriuin e Kosovës dhe që qëllimi i tij do të jetë gjetja e një rrugë për integrimin gradual të veriut në Kosovën e pavarur. Ky proces në teori, duhet t’i lejojë Serbisë që gradualisht të lëviz drejt njohjes së Kosovës, ashtu që njohja të afrohet krahas afrimit të Serbisë në BE⁶⁹.

Raundi i ri i dialogut duhet të marrë parasysh më shumë dimensionin politik dhe të jetë më ambicioz. Një qasje e tillë vie si rezultat i suksesit të arritjes së marrëveshjeve të deritanishme, nga nevoja për të siguruar zbatimin dhe nga fakti që çështje të rëndësishme të jashtëzakonshme janë kryesisht më shumë të ndjeshme dhe “politike” se sa ato të diskutuara deri më tani.

Disa tema mbeten të hapen në dialogun e ri i cili do të ndodhë pas formimit të qeverisë së serbe. Kosova ende duhet të korrë sukses me organizatat ndërkombëtare dhe t’i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë përderisa hapet dialog me përfaqësuesit e veriut.

Aspekti i parë ndërlihet me marrëveshjen për qasjen e Kosovës në organizata rajonale. Këtu, përqendrimi duhet të vihet në çështjen me simbolikë të ndjeshme të anëtarësimit

të plotë në organizata ndërkombëtare. Në fakt, theksi do të duhej të ishte në qasjen në disa agjenci dhe organe të specializuara që do t'i lejonin Kosovës tejkalimin e një numri pengesash, si marrja e kodit ndërkombëtar të telefonisë dhe domenit në internet.

Fusha e dytë përfshin çështjet e rëndësisë së përbashkët për bashkëpunim si: luftimi i krimit, narkotikëve, trafikimit me genie njerëzore dhe fenomenet e tjera negative që kanë ndikim negativ në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Përderisa, progres i shtuar është bërë në rajon në vitet e fundit, veçanërisht në luftimin e krimit, Kosova dhe Serbia nuk kanë bashkëpunuar⁷⁰. Një bashkëpunim i tillë është jetik për të ulur ndikimin e krimit të organizuar, veçanërisht ngase ai nxitet nga pasiguria ligjore në veri dhe mungesa e bashkëpunimit në mes të mekanizmave ligjor në të dy vendet.

Aspekti i tretë do të ishte diskutimi i çështjeve që dalin nga dialogu aktual. Diskutim i mëtutjeshëm duhet të ndodhë për t'i drejtuar marrëveshjet e arritura deri më tani në kahe të duhura. Për shembull, liria e lëvizjes duhet të përfshijë edhe transportin ajror, hekurudhor dhe rrugor si dhe diplomat universitare do të duhet të përfshinin nivele të tjera të arsimit por edhe Universitetin e Mitrovicës.

Niveli i katërt i bashkëpunimit ndërlihet me aftësinë e Qeverisë së Kosovës për të ushtruar autoritetin e saj. Kjo fushë e dialogut është më e ndjeshmja, për shkak se përfshin gjithsesi diskutimin mbi veriun e Kosovës. Në qendër të këtyre diskutimeve do të jetë transformimi i institucioneve të themeluara nga Beogradi. Pra që këto institucione, të cilat e njohin Serbinë si autoritetin e vetëm qeverisës, të transformohen në struktura të cilat do të bashkëpunojnë gjithashtu me Prishtinën, të cilat gradualisht do të pranoheshin në kornizën institucionale të Kosovës.

Është e rëndësishme të gjendet një *modus vivendi* e cila do t'i mundësonte Kosovës qasje në anëtarësinë në së paku disa prej organizatave të specializuara ndërkombëtare pa u përballë me pengesat e Serbisë. Kjo duhet të bëhet paralelisht me gjetjen e mekanizmave që do të hapnin rrugën për progres në veri të Kosovës pa e përmendur statusi i veriut si një çështje për diskutim.

Dialogu i nivelit të lartë

Në mënyrë që të adresohet përfaqësimi i Kosovës dhe veriut, dialogu i kaluar do të duhej të avancohej për të përfshirë një komunikimi më intensiv—por në të njëjtën kohë më pak të strukturuar dhe formal—në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

BE-ja dhe SHBA-të duket që janë pajtuar që dialogu në mënyrë simbolike duhet të rifillojë me një takim të nivelit të lartë. Përmes raportuesit të Parlamentit Evropian Jelko Kacin, Presidenti i Serbisë, Nikoliq shprehu gatishmërinë e tij për të takuar së pari homologen e tij nga Kosova, Presidenten Atifete Jahjaga⁷¹.

Ish-Sekretari i Shtetit në Ministrinë për Kosovën Oliver Ivanoviq ka deklaruar që Presidenti dhe Kryeministri serb nuk do të jenë pjesë e ekipit negociues në bisedime me Serbinë⁷². Ai ka thënë që ajo do të interpretohej si njohje e drejtpërdrejtë apo e të tërthortë e pavarësisë së Kosovës. Megjithëse ka qenë e rëndësishme të bëhet ngritja e nivelit politik të negociuesve, Ivanoviq e sheh si të dëmshme (për Serbinë) që ato të realizohen në nivel të krerëve të shtetit. Profesori i shkencave politike, Predrag Simiq po ashtu e sheh si të rrezikshëm një takim të tillë dhe si njohje *de facto* të Kosovës si shtet i pavarur⁷³. Ish krye-negociatori i Serbisë, Borislav Stefanoviq, ka deklaruar që kreu i shtetit është edhe bartësi i sovranitetit dhe nëse ai pranon që të ulet për bisedime apo të shtrëngoj duart, do të thotë se Kosova dhe Serbia janë të barabartë⁷⁴.

Një takim i tillë nuk është mirëpritur as në Kosovë. Një nga kolumnistët më me ndikim ka shkruar:

Unë mendoj që një takim i tillë, edhe nëse do të mbahej pa simbole të shtetit, ai më shumë do të përkeqësonte raportet e Kosovës dhe Serbisë, se sa t'i përmirësonte ato, por po ashtu do t'i kontribuonte edhe përkeqësimit të raporteve politike Brenda Kosovës⁷⁵.

Është ende e paqartë nëse bisedimet e nivelit të lartë do të përdoren për t'i dërguar porosi publikut, nëse do të shihen si rezultat më vete apo si shtytje për nivelet më të ulëta. Simeon Pobuliq, një anëtar i Forumit për Marrëdhënie Ndërkombëtare mendon që bisedimet mund të ngritën “në një nivel më të lartë nëse ke zgjidhje për çështje të rëndësishme dhe ato duhet të përkrahen me shumë autoritet”⁷⁶.

Dialogu me udhëheqësit e veriut

Duhet të ketë dialog jo-formal në mes të Prishtinës dhe përfaqësuesve serbë nga veriu i Kosovës. Duke i pasur parasysh dallimet dhe duke u respektuar reciprokisht, një shkëmbim në mes të Prishtinës dhe udhëheqësve të veriut do të mund të ndihmonte mirëkuptimin. Kjo do të mund të hapte rrugë për bashkëpunim praktik dhe të krijonte një klimë të përshtatshme për bashkëpunim, si parakusht i progresit politik.

Kjo temë diskutohet në një punim tjetër që publikohet nga PER-K (D4D) njëkohësisht me këtë. Është me rëndësi të merret në konsideratë një metodë e re e cila do të krijonte një linjë të drejtpërdrejt të komunikimit në mes të përfaqësuesve politik të veriut dhe qeverisë së Kosovës. Ndërveprimi i mirëfilltë së pari duhet të ketë për qëllim krijimin e besimit dhe së dyti krijimin e mundësisë për marrëveshje.

Një dialog politik në mes të Prishtinës dhe përfaqësuesve serbë, me përkrahjen e plotë të komunitetit ndërkombëtar, mund të arrijë në gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme dhe të qëndrueshme për veriun. Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë të investojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në veri përderisa do të përmirësojë zbatimin e të drejtave të minoriteteve në të gjithë Kosovën. Përderisa i njeh dallimet e natyrshme, sukcesi i qeverisë me serbët e jugut mund të krijojë momentumin për progres në të ardhmen në veri.

Serbët e veriut, në anën tjetër, duhet të angazhohen në dialog me Prishtinën duke treguar vullnet të mirë për krijimin e strukturave të pranueshme qeverisëse. Në të njëjtën kohë, Beogradi duhet të jetë konstruktiv në vazhdimin e dialogut me Prishtinën. Receta mund të jetë në rregullimin e përfshirjes së tërthortë të Beogradit në dialogun e Prishtinës me përfaqësuesit serbë të veriut, megjithëse kjo është çështje shumë e ndjeshme. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara duhet të përdorin ndikimin e tyre në ofrimin e udhëheqjes dhe garancive të nevojshme për palët e përfshira në gjetjen e një zgjidhjeje për veriun.

Dialogu serb-serb

Dialogu serb-serb është po ashtu jetik, pasi që shumë nga sfidat e komunitetit serb të përfshirë në Qeverinë e Kosovës kërkojnë që serbët së pari t'i zgjidhin dallimet e brendshme.

Shumë serbë nuk duan të bashkëpunojnë me më bashkëkombësit e tyre të cilët marrin pjesë në institucionet e Kosovës. Ata i konsiderojnë si tejet lojal ndaj Prishtinës dhe që brengosen vetëm për interesat personale. Frika e të qenit partner i vogël i Prishtinës vihet re më së miri nga shembulli i Graçanicës, ku perceptimi i “shqiptarizimit” të demografisë së komunës është interpretuar si shenjë se si zyrtarët serbë janë thjesht duke “i shërbyer zotëve të tyre shqiptarë”. Disa

liderë paralel serbë e akuzojnë udhëheqjen aktuale serbe si të imponuar nga autoritetet dhe jo të zgjedhur nga populli.

Serbët e Kosovës kanë mbetur pa elitë intelektuale dhe ende duhet të identifikojnë liderë të cilët do ta mbushin vakumin e mungesës së Beogradit. Shumë serbë nuk i konsiderojnë përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës si përfaqësues të qëndrimeve politike të shumicës së komunitetit serb, gjë që edhe më shumë e rritet nevojën për një dialog serb-serbë.

Dialogu serb-serb duhet të intensifikohet. Duhet të gjenden mënyra për të shtyrë Beogradin ta pranojë Partinë e Pavarur Liberale (*Samostalna liberalna stranka* apo SLS-në) dhe parti e liderë të tjerë serbë të jugut. Kjo duhet të përfshijë përpjekje për t'i inkurajuar këta politikanë që të marrin pjesë në dialog konstruktiv me udhëheqësit serbë në veri. Disa ngjarje të tilla tanimë po organizohen nga Këshilli për Qeverisje Inkluzive.

Dinamika e proceseve të reja

Kurrë nuk është koha e duhur

Për të qenë i suksesshëm, çdo ndërmjetësim duhet të ketë parasysh ciklin zgjedhor të palëve të përfshira dhe gjërave tjera të ngjashme. Mundësitë për marrëveshje janë më të mëdha kur palët nuk detyrohen të bëjnë kompromise në prag të zgjedhjeve kur edhe duhet dhënë llogari para elektoratit. Ky elektorat mund të jetë i ndikuar emocionalisht nga çështja apo të ndikuar nga dashakeqësit që kanë interes për të sabotuar kompromisin.

Në të njëjtën kohë, ekziston rreziku i shtyrjes së bisedimeve për çështje të ndjeshme për shkak të rrethanave të jashtme. Krahas zgjedhjeve në vendet të përfshira në bisedime, zgjedhjet në kryeqendrat botërore, si p.sh zgjedhjet presidenciale në SHBA mund të përdoren si argumente për kohë më të përshtatshme. Prandaj një element i rëndësishëm i çdo dialogu është vazhdimësia dhe koha. Në veçanti, është me rëndësi që të shfrytëzohen dritaret e mundësisë, që zakonisht janë të ngushta, për të arritur marrëveshje dhe për të siguruar vazhdim kuptimplotë të një dialogu.

Ekziston një ndjenjë e përgjithshme që koha po kalon dhe se komuniteti serb posaçërisht ndjehet nën presion për të arritur rezultate para se të bëhet shumë vonë. Përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) i vendos edhe serbët edhe shqiptarët në gjendje alarmi. Autoritetet frikësohen që largimi i ZCN-së do të shuajë mundësinë e përdorimit të pranisë së saj si ndihmë për të shtrirë autoritetin e vetë në veri. Serbët i janë frikësuar pasojave të humbjes së përkrahjes dhe mbikëqyrjes nga ZCN-ja për t'u siguruar që autoritetet e Kosovës i përmbahen obligimeve të tyre në lidhje me të drejtat e pakicave. E rëndësishme është që ky vit konsiderohet si vit

kyç për veriun dhe në masë të madhe besohet që periudha në mes të shtatorit dhe dhjetorit do të përcaktojë se si do të adresohet veriu nga tani e tutje.

Është një fazë e natyrshme e secilit cikël të konflikteve kur konflikt i ngrirë vjen në një pikë kur të dyja palët e kuptojnë që nuk mund të marrin atë çfarë dëshirojnë me dhunë të mëtutjeshme. Për më tepër, nëse konflikti është relativisht i gjatë dhe vendet mund të arrijnë në të njëjtën kohë zhvillim në fusha tjera, mosmarrëveshja bëhet e shtrenjtë, me mundësi që kostoja oportune të jetë shumë e lartë.

Kosova dhe Serbia janë me fat që një palë e tretë ka qenë shumë e interesuar që të arrijë pajtimin në mes tyre. Bashkimi Evropian ka luajtur kartat e veta, edhe pse nuk ka bërë shumë që t'i sjellë të dyja palët në një kornizë të vetme për qasje të mosmarrëveshjes. Përkundër mungesës së dialogut, i njëjti shpejt morri hov. Të dy palët nuk kanë lëvizur para, por mungesa e progresit të vërtetë drejtë BE-së ka filluar të bëhet politikisht më e kushtueshme për lidhshmërinë sesa vendimet jo-popullore që ata kanë marrë gjatë procesit të dialogut.

Ndërmjetësuesi 2.0

Bashkimi Evropian akoma nuk e di se në çfarë drejtimi do të vazhdojë dialogu në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Ngritja e profilit të negociatorëve do të nënkuptonte ngritjen e profilit të ndërmjetësuesit të brendshëm. Në këtë rast, roli i negociatorit do t'i kalonte përfaqësues së lartë të BE-së, Baroneshës Catherine Ashton nga ish negociatori Robert Cooper⁷⁷.

Një pyetje kryesore që duhet ta parashtrijë para vazhdimit të dialogut është nëse struktura e dialogut të tanishëm është e mjaftueshme. Ndërmjetësimi deri më tani nga BE-ja në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës ka qenë një çështje e profilit të ulët. Robert Cooper nuk ka qenë një

diplomat i nivelit të lartë, krahasuar me ish ndërmjetësuesin Kosovë-Serbi Martti Ahtisaari. Përzgjedhja e Cooperit si ndërmjetësues ka reflektuar natyrën teknike të dialogut dhe lidhjen e ngushtë që ai ka pasur me strukturën institucionale të BE-së. Fakti që z. Cooper e ka pasur të vështirë për të arritur marrëveshje ka reflektuar dobësinë e tij që të imponojë rezultat.

Temat politike të raundit të ri kërkojnë fuqi më të madhe politike nga ndërmjetësuesi, gjë që shtron nevojën për një ndërmjetësues të nivelit më të lartë. Një ndërmjetësues i tillë do të kishte më shumë mundësi për t'ju ofruar palëve shpërblime konkrete për marrëveshjet e arritura dhe të bënte më shumë presion tek palët për të arritur marrëveshje. Emërimi i një diplomati të lartë dhe me përvojë po ashtu do të dërgonte një mesazh që bisedimet dhe sukcesi i tyre janë një prioritet i lartë i BE-së.

Një ndërmjetësues i nivelit të lartë do të kishte nevojë po ashtu për një përfshirje aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që është thënë së fundmi nga Stefan Lehne⁷⁸. “Vjen momenti, vjen gruaja,” është shkruar në një blog të Wall Street Journal, duke raportuar që Baronsha Ashton “është duke marrë më shumë rol në bisedime duke u përpjekur që të rihapë energji”⁷⁹. Baronsha Ashton po ashtu duhet të përfshijë më shumë komunitetin serb në proces, së paku përmes konsultimeve të kohëpaskohshme mbi atë se cilat janë preferencat e tyre.

Në mënyrë që veprimi të jetë i efektshëm, shpërblimi potencial për çdo marrëveshje duhet të jetë i qartë. Bashkimi Evropian deri më tani ka qenë i fokusuar në ofrimin e përfitimeve që kanë të bëjnë me pranimin e Serbisë në BE si shtytje. Sidoqoftë, ashtu siç u tha edhe më herët, BE-ja duhet të identifikojë shtytje të qarta edhe për Kosovën. Përveç kësaj, BE-ja duhet të konsiderojë ofrimin e shtytjeve shtesë, siç është asistenca substanciale për zbatimin e marrëveshjeve të arritura gjatë raundit pasues të dialogut.

Renditja e kujdesshme

Dialogu politik i ardhshëm do të ketë shumë elemente të një procesi paqësor. Çdo proces paqësor kërkon disa kushte:

- a. Protagonistët duhet të kenë gatishmëri që të negociojnë me vullnet të mirë
- b. Akterët kryesorë duhet të jenë të përfshirë në proces
- c. Negociatat duhet të adresojnë çështjet kryesore të mosmarrëveshjes
- d. Forca nuk duhet përdorur për të arritur objektivat
- e. Negociatorët duhet të jenë të përkushtuar për një proces të qëndrueshëm

Këto bisedime nuk mund vetëm të rifillojnë nga aty ku janë lënë në fillim të vitit 2012. Ndryshimi në Serbi si rezultat i zgjedhjeve të majit dhe mësimet e nxjerra nga raundet e mëhershme, kanë bërë që të rikonsiderohet formati dhe përbërja e dialogut. Është thelbësore që BE-ja të mendojë një gjë të tillë kur të përgatisë fazën tjetër të bisedimeve dhe që të kërkojë përkushtimin paraprak të të gjitha palëve që ato do të zbatojnë ato që u përmendën më lartë.

Procesi i këtyre bisedimeve duhet të harmonizohet me shpërblimet që BE-ja mund t'ju ofrojë Serbisë dhe Kosovës në aspekt të procesit të anëtarësimit. Ka nevojë për standarde të qarta mbi substancën e marrëveshjeve ndërmjet dy palëve dhe lidhjes së tyre me faza të ndryshme të anëtarësimit në BE. Siç e thotë Stefan Lehne, përderisa të dy vendet bëjnë hapa të rëndësishëm drejtë BE-së, ata duhet po ashtu të lëvizin dukshëm drejtë marrëdhënieve normale me njëra tjetrën⁸⁰.

Një sfidë madhore vjen nga fakti që Serbia dhe Kosova nuk janë në distancë të njëjtë me BE-në dhe janë në faza të ndryshme të procesit të anëtarësimit. Një situatë e tillë

asimetrike nënkupton që edhe shtytjet dhe shpërblimet dallojnë në masë të madhe. Përderisa Serbia synon fonde strukturale dhe anëtarësim, Kosova dëshiron një marrëdhënie të qartë politike dhe ekonomike me BE-në, heqje të vizave, si dhe konsolidimin e shtetësisë së vetë dhe kontroll të tërë territorit të saj.

BE-ja duhet të ofrojë shpërblime që janë të balancuara dhe të bazuara në performancë, duke vendosur një dinamikë të qartë të procesit që largon perceptimin e asimetrisë të 'karotave' që i ofron. Simetria duhet të vendoset në mënyrë të kujdesshme dhe me planifikim kohor të kujdesshëm.

Radhitja është thelbësore në sigurimin e suksesit të dialogut. Nëse shpërblimet ofrohen shumë herët, shtytjet për kompromis dobësohen; nëse ato ofrohen shumë vonë, tërheqja e anëtarësimit në BE mund të zbehet dhe të rrezikohet procesi. Kushtëzimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i parashikueshëm. Nëse kushtet e vëna janë shumë të larta dhe ndalohen shpërblimet, ky 'shkop' duhet të jetë i besueshëm dhe mos të rrezikojë shtytjen e përgjithshme për integrim në BE.

Një sfidë tjetër në këtë aspekt është sigurimi që procesi nuk shpie në një situatë ku njëri vend e bllokon anëtarësimin e tjetrit në BE, përmes bllokimit të negociatave⁸¹. BE-ja duhet hapur ta theksojë që ajo do të dënojë palët që nuk dialogojnë me vullnet të mirë apo dështojnë të zbatojnë marrëveshjet e arritura.

Radhitja duhet të lejë pak hapësirë për fleksibilitet por vetëm në aspekt teknik dhe të sigurohet që publiku në të dy vendet janë të informuar. Në nivelin strategjik, është e qartë që para progresit të mëtutjeshëm, Serbia duhet të ndërtojë marrëdhënie më normale me Kosovën, dhe drejt avancimit për anëtarësim në BE, ajo nuk duhet të ketë mosmarrëveshje të hapura territoriale.

Ndërmjetësim i fuqishëm

Procesi i përshtuar më sipër nënkupton përfshirjen e një ndërmjetësuesi që do të përdor metoda intensive të ndërmjetësimit. Është një vendim i qartë mbi procesin tani që pa një ndërmjetësim dhe presion nga ana e BE-së, dialogu nuk do të sillte asnjë rezultat. Ajo që është quajtur ndërmjetësim në fakt është shumë më shumë se aq, ngase ka përfshirë vendosjen e agjendës, elaborimin e zgjidhjeve dhe përdorimin serioz të karotës dhe shkopit për t'i shtyrë palët që të përfshihen.⁸²

Një zyrtar evropian ka deklaruar që BE-ja është e gatshme që të përdor një qasje më gjithëpërfshirëse për të zgjidhur çështjen e Kosovës. Qasja bazohet në tri shtylla kryesore të cilat janë shumë të mira si strategji fillestare. Kjo i referohet po ashtu edhe vullnetit të Ashton për tu përfshirë personalisht në bisedime në çështjet më të rëndësishme në dialog, në qëllimin për tu siguruar që dialogu do të ketë lidhje të ngushta me procesin e zgjerimit të BE-së dhe së treti që palët të fokusohen në rezultatin final të bisedimeve. Shtylla e dytë e strategjisë fokusohet në sigurimin e lidhjeve më të fuqishme të dialogut me procesin e zgjerimit dhe nënkupton përdorimin e instrumenteve të caktuara dhe ofrimin e udhëzimeve për palët relevante në dialog, si dhe bisedimet që mund të vazhdojnë nëse gjithçka shkon siç duhet.⁸³

Dy palët vendore—shqiptarët dhe serbët—ka më pak të ngjarë që të shkojnë përtej historisë së tyre. Ata besojnë që pranimi i disa pozicioneve të kompromisit janë shenjë e dobësisë. Ata po ashtu mund të ndihen që toka po lëviz nën ta—Beogradi mund t'i braktisë serbët, BE-ja mund të dëshirojë qasje të re nga shqiptarët. Pa ndihmë nga jashtë, asgjë e mirë nuk duket që do të vjen.⁸⁴

Përvoja e deritanishme ka treguar që Beogradi dhe Prishtina nuk do të ndërmarrin hapa jo-popullor dhe të guximshëm pa pasur presione të fuqishme nga komuniteti ndërkombëtar. Nuk ka asnjë precedent kur Prishtina dhe

Beogradi kanë arritur vet marrëveshje apo që kanë bashkëpunuar me vullnetin e tyre. Edhe bashkëpunimi në çështje humanitare si personat e zhdukur, është rezultat i presionit ndërkombëtar.⁸⁵

Deklarata të shumta ilustrojnë dobësinë e lidërshiptit për të arritur kompromise.

Në qoftë se komuniteti ndërkombëtar nuk do të veprojë në mënyrë të guximshme, veriu do të mbetet një konflikt i ngrirë edhe për shumë vite të tjera. Një pjesëmarrës serb është pajtuar që konflikti i ngrirë do të vazhdojë deri në momentin kur Serbia dhe Kosova ta dinë se ku janë kufijtë e tyre.⁸⁶

Shkalla e transformimit të nevojshëm është aq e madhe ndërsa koha aq e limituar sa që vetëm kushtëzimi i fuqishëm mund të ndihmojë transformimin e raporteve dhe t'i vë në lëvizje reformat në të dy shtetet.

Shumë akterë besojnë që zgjidhja “duhet të vjen nga lart” dhe disa besojnë që kjo “duhet të ndodh me imponim”. Akterët lokal shpeshherë i justifikojnë kompromiset duke thënë se “është dashur ta bëjnë” si rezultat i presionit. Në fakt, kjo më shpesh përdoret si justifikim se sa që presioni ushtrohet me të vërtetë.

Disa analistë besojnë që Beogradi dhe Prishtina duhet të zgjidhin mos-marrëveshjet reciproke vet në vend që gjithmonë të kërkojnë asistencë nga komuniteti ndërkombëtar.⁸⁷

Një situatë e tillë sinjalizon faktorët e jashtëm që të tregojnë rrugën e mesme. Kjo nuk duhet të kalojë në arbitrim por në ndërmjetësim të udhëhequr kujdesshëm. “Imponimi” mund të mirëpritet nga lidërshipti mirëpo e sjell rrezikun që elitat nuk do të mund të pretendonin marrjen e pronësisë dhe do të linin një dritare për tu rebeluar ndaj marrëveshjeve më vonë.

Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, Samuel Zbogar, tanimë ka paralajmëruar që pas përfundimit të mbikëqyrjes të pavarësisë, Bashkimi Evropian do të marrë rol dhe përgjegjësi më të madhe për Kosovën. Pozita e serbëve duhet të ketë më shumë fokus.⁸⁸

Një indikator tjetër i një qasjeje të tillë serioze është që Baronsha Ashton dhe Sekretarja Amerikane e Shtetit Hillary Clinton, janë duke e përgatitur një “platformë për normalizimin e raporteve në mes të Serbisë dhe Kosovës” i cili do të aprovohet nga kryeministrat e të dy shteteve.⁸⁹

Vetëm një ndërmjetësim i tillë i fuqishëm dhe i nivelit të lartë ka mundësi të tejkalojë pozicionet fikse të liderëve dhe të transformojë perceptimin e interesit vetanak të të gjithëve. Integrimi në BE është efektiv për zgjerimin e së kulaçit dhe vendosjen e shpërblimeve për të dy palët. Por tejkalimi i mungesës së bashkëpunimit duhet të jetë një shpërblim më vete të cilin elita dhe publiku i të dy shteteve duhet ta zbulojnë së shpejti.

Hapi final

Ky punim nuk ka për qëllim të ofrojë një zgjidhje të hollësishme për veriun apo për Serbinë dhe Kosovën. Prapëseprapë, rruga e mesme për Prishtinën dhe Beogradin po bëhet e evidente vetvetiu. Zgjidhja vështirë që të gjendet vetëm përmes një dialogu parimor dhe të mirëfilltë në mes të palëve; prandaj, mundësitë më të mira janë që ndërmjetësuesit tu ndihmojnë t'i zbulojnë marrëveshje të pranueshme. Për më shumë, BE-ja e ka mundësinë që të bëjë që veprimet jo bashkëpunuese t'i kushtojnë shumë lidershipit të të dy shteteve.

Përderisa Beogradi po e rithekson fjalinë e shumë-përsëritur e të dalë mode që Serbia kurrë nuk do ta njoh pavarësinë e Kosovë, ajo çdo ditë e më shumë do ta kuptojë që raportet me Kosovën dhe perspektiva e qartë evropiane janë në

interesin e saj. Kjo do të përfshijë zbatimin e marrëveshjeve në mënyrë implicite dhe konsolidimin e pavarësisë kundër së cilët po punon në mënyrë eksplicite.⁹⁰

Në anketimet e fundit, në mes të 60 dhe 70 përqind e qytetarëve në Serbi thonë që Kosova është humbur dhe ky është realiteti. Politikanët nga elita e re demokratike përmes leximit të këtyre anketimeve, mund tu thotë qytetarëve atë që ata tanimë e dinë.⁹¹ Në të njëjtën kohë, si pjesë e një dialogu të pranuar përbrenda dhe të përkrahur ndërkombëtarisht, Beogradi i plotëson konditat e veta të posaçme nacionale dhe ndërkombëtare. Megjithëse një gjë e tillë do të shënonte një kthesë politike në Serbi, ajo nuk do të nënkuptonte humbjen e votave.

Prishtina ngjashëm do ta kuptojë që angazhimi në dialog është i vlefshëm në shkëmbim për arritjen e bashkëpunimit me Serbinë dhe njohjes eventuale. Përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, Kosova ka potencial që të gjejë modalitete të përshtatshme për të zbatuar planin e Ahtisaarit në veri dhe në të gjithë territorin e saj. Kjo njëkohësisht do të vazhdojë të zhbllkojë pjesëmarrjen e Kosovës në organizata ndërkombëtare, duke sjell përfitime në përpjekjet për zhvillim ekonomik, social dhe politik të vendit.

BE-ja duhet të dëshmojë që përmes dialogut dhe me liderët e rajonit, është duke punuar për qytetarët e Ballkanit. Në mënyrë që të zotohet fuqishëm për pajtim dhe për një Evropë më të bashkuar, BE-ja duhet të përdor dialogun dhe mjete të tjera për të detyruar lidërshtipin aktual të Kosovës dhe Serbisë që të bëjnë përpjekje më të mëdha drejt integritimit evropian.

Rekomandimet

Pavarësisht përvojës së përzier me dialogun teknik, është e vështirë që të këshillohet diçka tjetër përveç vazhdimit të bisedimeve. Bisedimet duhet të japin disa rezultate: (a) përmirësojnë marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës, (b) adresojnë mosmarrëveshjet kryesore të dy vendeve, dhe (c) gradualisht të transformojnë bisedimet e ndjeshme në marrëdhënie të rregullta që duhet të kultivojnë dy vende fqinje.

Prishtina duhet të përgatitet që ti qaset liderëve të veriut në një dialog konstruktiv. Në të njëjtën kohë, autoritetet kosovare duhet të kenë një qasje 'jo-lënduese' ndaj veriut. Prishtina duhet të kujdeset më shumë në atë se si i formulon porosinë e saj për veriun. Kërcënimet e perceptuara i mobilizojnë serbët e veriut që të dalin në mbrojtje të elitave që kontrollojnë këtë hapësirë. Qeveria e Kosovës duhet të përmbahet nga çdo hap i njëanshëm sa i përket veriut përderisa dialogu me Beogradin dhe po ashtu me serbët e Kosovës në veri vazhdon. Autoritetet duhet të vazhdojnë të përmirësojnë situatën e serbëve të veriut.

Qeveria e re në Beograd duhet të zbatojë në tërësi marrëveshjet e arritura gjatë raundeve të mëhershme të dialogut. Ekipi negociator duhet të jetë gjithëpërfshirës ndaj akterëve kryesor politik në Serbi dhe të sigurojë përkrahje të gjerë në mesin e partive parlamentare për çdo marrëveshje të arritur. Një konsensus duhet të gjendet për procesin, përderisa një platformë eksplicite para procesit mund të kufizojë hapësirën manovruese të Beogradit.

Beogradi duhet të nxisë serbët e veriut që të përfshihen në komunikim më të gjerë me Prishtinën, qoftë kjo për çështje si uji apo grumbullimi i mbeturinave si tema fillestare. Beogradi duhet të përkrahë zgjidhje nga të cilat përfitojnë serbët në veri dhe në jug. Beogradi mund të konsultojë

liderët e serbëve të veriut për preferencat e tyre por nuk duhet të përfshijë ata në ekip negociues.

Qeveria e Serbisë duhet të heqë embargon ndaj Kosovës dhe duhet të jetë e gatshme të diskutojë kushtet për qasjen e Kosovës në organizatat dhe trupat e specializuara ndërkombëtare. Ka shumë hapësirë që të përfitojnë të dy palët nga një veprim i tillë.

BE-ja dhe akterët tjerë ndërkombëtarë duhet të zgjerojnë dialogun për të mbuluar çështje që deri me tani kanë qenë të përjashtuara, siç është qasja e Kosovës në organizata ndërkombëtare të specializuara, telekomunikimi, sikurse edhe çështje tjera shtesë me përfitim të dyanshëm si sporti ndërkombëtar, etj.

BE-ja duhet të lehtësojë kanale shtesë të komunikimit ndërmjet Prishtinës dhe serbëve të veriut dhe kanale jo-formale të komunikimit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

BE-ja duhet të përgatisë shtytje të qarta për raundin e ri të dialogut dhe të sigurojë që shpërblimet janë adekuate për të dy palët. Marrëveshje tjera duhet të nënshkruhen dhe të bëhen transparente. Marrëveshjeve që sjellin përfitime të prekshme për qytetarët duhet tu epet prioritet në mënyrë që të ketë pranueshmëri më të madhe tek publiku.

BE-ja duhet të përcaktojë qartë se çfarë nënkupton 'normalizimi' i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës si rezultat afatmesëm i dialogut. Në aspektin praktik, si shembull BE-ja duhet të detyrojë udhëheqjen në Kosovë dhe Serbi që të veprojnë kundër interesave të kompanive të sigurimit dhe të pajtohen që të ulin taksën e sigurimit ndërkufitar. Duhet gjetur një zgjidhje që promovon ndërveprimin deri sa të gjendet një zgjidhje e përhershme në mënyrë që Kosova të bëhet anëtare e Byrosë së Kartonit të Gjellbërt ose në bazë të meritave të saj apo përkohësisht përmes ndonjë vendi të tretë.

Fusnotat

- ¹ Berisha, Ridvan. 7 mars 2003. Kosovë: Nuk ka entuziazëm për bisedime me Beogradin. IWPR's Balkan Crisis Report, Nr. 412.
- ² Gazeta Zyrtare e qeverisë së Serbisë nr. 16/12.
- ³ Shih komunikatën për media të Zyrës së BE-së, 27 qershor 2012.
- ⁴ Shih rregulloren mbi qeverinë serbe. Gazeta Zyrtare 94/11.
- ⁵ Qëndrim i mbajtur nga autoritetet e Kosovës dhe në masë të madhe edhe nga BE.
- ⁶ B92. 8 qershor 2012. EULEX: marrëveshja për targat e makinave vlen për tërë Kosovën. http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2012&mm=06&dd=08&nav_id=80664
- ⁷ Beta. 3 mars 2012.
- ⁸ Politika. 8 mars 2012. Bogdanoviq: Nuk ka afat për reregjistrimin e makinave në Kosovë dhe Metohi.
- ⁹ Politika. 9 mars 2012. Thirrje për serbët që mos të marrin dokumentet e Kosovës.
- ¹⁰ B92. 8 March 2012.
- ¹¹ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 4.
- ¹² Politika. 16 prill 2012. Fule: Do t'ua përkujtoj marrëveshjet Beogradit dhe
- ¹³ Siç është Komuniteti i Energjisë, CEFTA, Observatori i Transportit të Evropës Juglindore, Zona e Përbashkët Evropiane e Fluturimit, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, etj.
- ¹⁴ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 11.

- ¹⁵ Vaquer i Fanés, Jordi and Cristian Ghinea. Mard 2012. Rifikimi i Agjencisë: Si të ndihmohen Serbia dhe Kosova të lëvizin drejt BE-së - Një shqyrtim kritik i mosnjohjes së Kosovës. [Analizë politike]. Publikuar nga the Barcelona Centre for International Affairs (CIDOB), dhe the Romanian Centre for European Policies (CRPE). p. 1.
- ¹⁶ KTV. 11 tetor 2012. Zhbogar: Marrëveshja për fusnotën lejon dialogun për Marrëveshjen Stabilizim Asociim.
- ¹⁷ Express. 21 mars 2012. Rregullat e tyre .
- ¹⁸ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 4.
- ¹⁹ TV21. 3 shtator 2012. Daqiq: Serbia do të respektojë të gjitha marrëveshjet e arritura me Kosovën.
- ²⁰ Vaquer i Fanés, Jordi and Cristian Ghinea. Mard 2012. Rifikimi i Agjencisë: Si të ndihmohen Serbia dhe Kosova të lëvizin drejt BE-së - Një shqyrtim kritik i mosnjohjes së Kosovës. [Analizë politike]. Publikuar nga the Barcelona Centre for International Affairs (CIDOB), dhe the Romanian Centre for European Policies (CRPE). p. 1.
- ²¹ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 1.
- ²² Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.
- ²³ Todoric, Vladimir dhe Leon Malazogu. Dhjetor 2011. Dialogu Beograd-Prishtinë: Kërkohet Transformimi i interesit vetanak. Projekti për Marrëdhënie Ndëretnike – Kosovë dhe Qendra për Politka të Reja. Prishtinë/Beograd.
- ²⁴ Kur fitorja e njëres palë, sipas përkufizimit, vie në llogari të tjetrës, dhe rrjedhimisht nuk mund të dalin fituesë të dy palët e një përballjeje.

- ²⁵ Todoric, Vladimir dhe Leon Malazogu. Dhjetor 2011. Dialogu Beograd-Prishtinë: Kërkoet Transformimi i interesit vetanak. Projekti për Marrëdhënie Ndëretnike – Kosovë dhe Qendra për Politka të Reja. Prishtinë/Beograd.
- ²⁶ Cas Sunstein, Designing Democracy. Çfarë bëjnë Kushtetutat? (New York: Oxford University Press 2001), 60.
- ²⁷ Cas Sunstein, Designing Democracy. Çfarë bëjnë Kushtetutat? (New York: Oxford University Press 2001), 60.
- ²⁸ Politika. 16 prill 2012. Fule: Do t'ua përkujtoj marrëveshjet Beogradit dhe Prishtinës.
- ²⁹ Capussela, Andrea Lorenzo. 13 mars 2012. Kosova: mendime të qarta mbi fusnotën.
- ³⁰ Telegrafi. 10 maj 2012. Serbët e Kosovës i frikësohen ngritjes së Daçiqit.
- ³¹ UNDP. Dhjetor 2011. Puls i Publik: Fakte të shpejta III. Faqe 9.
- ³² Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 12.
- ³³ Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.
- ³⁴ Gazetat ditore. 20 mars 2012.
- ³⁵ Klan Kosova. 20 mars 2012.
- ³⁶ Kjo nuk ka qenë hera e parë kur një qeveri e udhëhequr nga PDK ka pranuar rezolutën 1244 pas pavarësisë. Këtë e ka bërë edhe më herët për të të theksuar dispozitat e rezolutës 1244 për të konfirmuar integritetin territorial të njohur ndërkombëtarisht.
- ³⁷ Radio Kosova. 24 maj 2012. Krasniqi ka thanë që rekomandimet e aprovuara nuk janë obliguesve për qeverinë.
- ³⁸ Express. 9 mars 2012. Serbia ka filluar një fushatë, thotë Skënder Hyseni.
- ³⁹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave . 2 shkurt 2012. Kosova dhe Serbia: Një vullnet i vogël i mirë do të mund të hapte shumë rrugë. Europe Report N°215 – 2 shkurt 2012. f. 18.

- ⁴⁰ Bajrami, Agron. 29 qershor 2012. Koha Ditore.
- ⁴¹ Bilefsky, Dan. 21 maj 2012. Të zgjedhurit e rinj, serbët e konfirmojnë përkushtimin për integrim në BE. The New York Times. http://www.nytimes.com/2012/05/22/world/europe/newly-elected-serb-affirms-course-on-european-union.html?_r=0 (qasur për herë të fundit 26 shtator 2012).
- ⁴² B92. 30 gusht 2009. Tadiq mbi “katër shtyllat diplomatike” të Serbisë. http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=08&dd=30&nav_id=61454 (qasur për herë të fundit me 26 shtator 2012).
- ⁴³ Vecernje Novosti. 23 gusht 2012. Platforma për bisedime në përgatitje.
- ⁴⁴ Tanjug. 18 gusht 2012. DS përkrah zgjidhjen pa njohje të Kosovës.
- ⁴⁵ Serwer, Dan. 27 mars 2012. Politika e ShBA-së në Ballkanin Perëndimor. <http://www.peacefare.net/?p=7943> (qasur për herë të fundit 30 qershor 2012)
- ⁴⁶ B92. 8 mars 2012. Marnhac: Fletushkat shpjegim i marrëveshjes.
- ⁴⁷ Grupi Ndërkombëtar i Krizave . 2 shkurt 2012. Kosova dhe Serbia: Një vullnet i vogël i mirë do të mund të hapte shumë rrugë. Europe Report N°215 – 2 shkurt 2012. f. 18.
- ⁴⁸ Serwer, Dan. 27 mars 2012. Politika e ShBA-së në Ballkanin Perëndimor. <http://www.peacefare.net/?p=7943> (qasur për herë të fundit 30 qershor 2012)
- ⁴⁹ Gallucci, Gerard. M. 16 nëntor 2011. Kosova – Koha për një qasje të re. Transconflict.
- ⁵⁰ Shih studime mbi këtë nga Florian Bieber (ed.), Kushtëzimi i pakushtëzuar? Ndikimi i kushtëzimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. *Europe-Asia Studies*, Vol. 63, Nr. 10.
- ⁵¹ Deutsche Presse-Agentur. 9 shtator 2011. Kriteret e BE-së për Serbinë përfshijnë Kosovën, ka thanë Van Rompuy.
- ⁵² Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.

⁵³ Vaquer i Fanés, Jordi and Cristian Ghinea. Mars 2012. Rifikimi i Agjencisë: Si të ndihmohen Serbia dhe Kosova të lëvizin drejt BE-së - Një shqyrtim kritik i mosnjohjes së Kosovës. [Analizë politike]. Publikuar nga the Barcelona Centre for International Affairs (CIDOB), dhe the Romanian Centre for European Policies (CRPE). F. 2.

⁵⁴ Një qasje e tillë është madje edhe më e dukshme në Serbi pasi që Kushtetuta përmban edhe pretendimin mbi Kosovën edhe në Preambulën e saj, betimin e presidentit (neni. 114) dhe neni që përmend ekzistencën e Kosovës si një krahinë autonome. (neni. 182).

⁵⁵ Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.

⁵⁶ Vesti Online. 16 prill 2012.

⁵⁷ Politika. 10 nëntor 2011. Dialogu është kushti i vetëm për marrjen e statusit të kandidatit.

⁵⁸ Beta. 10 mars 2012

⁵⁹ Gallucci, Gerard. 12 tetor 2011. Kosovë – BE-ja kërkon dorëzimin. <http://www.transconflict.com/2011/10/kosovo-the-eu-demands-surrender-120/>

⁶⁰ Dacic Ivica. 13 dhjetor 2011. Njohja e Kosovës.

⁶¹ Most. 2 shkurt 2012. SNS: Ska njohje të Kosovës dhe Metohisë madje edhe me çmimin e BE-së.

⁶² Beta and Tanjug. 7 prill 2012.

⁶³ Beta 10 mars 2012

⁶⁴ Express. 16 prill 2012.

⁶⁵ Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.

⁶⁶ Blic. 25 qershor 2012. Analistët: Punë aktive për formatin e ri të bisedimeve.

⁶⁷ Koha Ditore. 23 mars 2012.

⁶⁸ Zëri. 12 mars 2012.

- ⁶⁹ Danas. 28 qeshor 2012. Nëse Tadiqi nuk është takuar me Jahjagën, pse duhet Nikoloqi? [Intervistë me Agron Bajrami, kryeredaktor i Koha Ditore.
- ⁷⁰ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 27 prill 2012. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2012/275, f. 5.
- ⁷¹ B92. 20 qershor 2012. Presidenti serb i gatshëm të takohet me homologen e saj kosovare.
- ⁷² KTV. 24 qershor 2012. Ivanoviq: Presidenti, kryeministri nuk do të marrin pjesë në bisedimet me Prishtinën.
- ⁷³ Simiq. 25 qershor 2012. Simiq: E rrezikshme që presidenti udhëheq bisedimet.
- ⁷⁴ Blic. 12 qershor 2012. Stefanoviq: Nuk kam asgjë kundër përfshirjes së serbëve të Kosovës në negociata (intervistë me Borislav Stefanoviq).
- ⁷⁵ Danas. 28 qeshor 2012. Nëse Tadiqi nuk është takuar me Jahjagën, pse duhet Nikoloqi? [Intervistë me Agron Bajrami, kryeredaktor i Koha Ditore.
- ⁷⁶ Politika. 26 qershor 2012. Rreziku nga ngritja e dialogut me Prishtinën në nivelin politik.
- ⁷⁷ Vecernje Novosti. 25 qershor 2012. Dialogu me Prishtinën: Ashton ndërmjetësuese?
- ⁷⁸ Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.
- ⁷⁹ Norman, Laurence. 29 gusht 2012. Ashton Mulls Serbia-Kosovo Role. Wall Street Journal Blog. <http://blogs.wsj.com/brussels/2012/08/29/ashton-mulls-serbia-kosovo-role/>
- ⁸⁰ Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.
- ⁸¹ Vaquer i Fanés, Jordi and Cristian Ghinea. Mard 2012. Rifitimi i Agjencisë: Si të ndihmohen Serbia dhe Kosova të lëvizin drejt BE-së - Një shqyrtim kritik i mosnjohjes së Kosovës. [Analizë politike]. Publikuar nga the Barcelona Centre for International

Affairs (CIDOB), dhe the Romanian Centre for European Policies (CRPE). p. 2.

⁸² Lehne, Stefan. Mars 2012. Kosova dhe Serbia: Drejt një marrëdhënie normale. Policy Outlook.

⁸³ B92 Online. 6 shtator 2012. Strategjia e BE-së për Kosovën.

⁸⁴ Gerard Gallucci. 10 nëntor 2011. Kosova – rrugë të ndara. *Trans conflict*

⁸⁵ Gashi, Shpëtim. 5 shtator 2012. Breaking Kosovo's northern deadlock. TransConflict. *Qasur për herë të fundit me 5 s2012 @: <http://www.transconflict.com/2012/09/breaking-kosovos-northern-deadlock-059/>*

⁸⁶ Këshilli për Qeverisje Inkluzive. 2012. Kërkimi i zgjidhjeve për veriun e Kosovës. New York.f. 10.

⁸⁷ KIM Radio. 9 gusht 2012. Beqaj: Beogradi dhe Prishtina duhet të zgjedhin vetë mosmarrëveshjet.

⁸⁸ 15 shtator 2012.

⁸⁹ Koha Ditore. 7 gusht 2012. Dialog i ri.

⁹⁰ Politika. 29 nëntor 2011. Thin mantra worn out, nga Obrad Kesiq.

⁹¹ Blic. 10 tetor 2011. Tregojnë njerëzve çfarë ata pothuajse e dinë – Kosova nuk është Serbi. Intervistë me Milan Nikoliq, sociolog.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

327(496.51:497.11)

Malazogu, Leon

Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen / Leon Malazogu dhe Florian Bieber ; me kontribut nga Drilon Gashi. - Prishtinë : Projekti për Marrëdhënie Etnike ; Demokracia për Zhvillim, 2012. - 78 f. ; 21 cm.

1.Bieber, Florian

2.Gashi, Drilon

ISBN 978-9951-8865-3-6

Që nga viti 2000 PER - Kosovë ka kontribuar në përmirësimin e dialogut politik ndëretnik dhe ka ndihmuar në integrimin e komunitetit serb. Duke filluar nga vera e vitit 2012, PER - Kosovë do të vazhdojë të funksionojë si program i Demokracisë për Zhvillim (D4D). Hulumtimi i politikave publike dhe tryezat rajonale do të identifikojnë mundësitë për përmirësuar tutje mirëbesimin ndëretnik dhe të adresojë çështjet praktike për ndërtimin e një mjedisi ndëretnik tolerant brenda Kosovës.



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni www.d4d-ks.org.



B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Kingdom of
the Netherlands

ISBN 978-9951-8865-3-6



9 789951 886536